



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

PROGRAMI I QEVERISJES
VENDORE NË SHQIPËRI

DOKUMENTE & PROÇEDURA MODEL PËR REALIZIMIN E SUKSESSHËM TË HUAMARRJES VENDORE

DOKUMENT PUNE PËR STAFET TEKNIKE TË NJËSIVE
TË QEVERISJES VENDORE

RISHIKUAR NË MARS 2011

Ky publikim u mundësua nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.
Ai u përgatit nga ARD, Inc.

Përgatitur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, Numri i Kontratës i USAID-it DFD-I-00-05-00121-00, Urdhëri i Punës 05, IQC Decentralizimi dhe Qeverisja Vendore Demokratike (DQVD) (Decentralizimi II)

Përgatitur nga: Ornela Shapo (Këmbora), LGPA / Lider i Komponentit për Zhvillimin Ekonomik Vendor

ARD Kontakti kryesor: Benjamin Lawrence

ARD Adresa e zyrës qendrore: ARD, Inc.
159 Bank Street, Suite 300, Burlington, VT 05401
Tel: 802 658-3890, Fax 802 658-4247
www.ardinc.com

DOKUMENTE & PROÇEDURA MODEL PËR REALIZIMIN E SUKSESSHËM TË HUAMARRJES VENDORE DOKUMENT PUNE PËR STAFET TEKNIKE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

SQARIM

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domozdoshmërisht ato të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	I
1. HYRJE.....	1
2. PROÇESI I HUAMARRJES DHE DOKUMENTET MODEL PËRKATËS.....	3
2.1 HAPAT QË REKOMANDOHET TË NDIQEN, AKTORËT QË PËRFSHIHEN DHE DOKUMENTET QË DUHET TË HARTOHEN NË PROÇESIN E HUAMARRJES VENDORE.....	3
2.2 DOKUMENTE MODEL QË REKOMANDOHEN PËR ÇDO HAP TË PROÇESIT.....	4
1. Format për Llogaritjen e Kufizimeve të Huamarrjes Vendore.....	7
2. Shkresë Informuese për Ministrinë e Financave për Planet e Huamarrjes.....	9
3. Shkresë për Thithjen e Interesit të Bankave / Institucioneve Financiare për të Financuar me Anë të Kredisë Projektet e Investimit të Njesisë Vendore.....	10
4.a. Shkresë për Dërgimin e Ofertës Tekniko-Financiare nga ana e Bankave / Institucioneve Financiare të Interesuara.....	11
4.b. Të Dhëna Financiare për Njesisë Vendore (si pika 1 më sipër).....	12
4.c. Përshkrimi i Projektit të Investimit që do të Financohet me anë të Huamarrjes Vendore.....	13
5. Urdhër i Kryetarit të Njesisë Vendore për Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Ofertave të Marra nga Bankat / Institucionet Financiare.....	14
6. Dokumenti i Vlerësimit të Ofertave të Marra nga Bankat / Institucionet e Interesuara.....	15
7. Shkresë Bankave në Lidhje me Ofertën e Dhënë për Njesisë Vendore.....	22
8. Njoftim i Publikut për Mbledhjen e Hapur të Këshillit të Njesisë Vendore për Diskutimin dhe Miratimin e Kredisë.....	23
9. Projekt Vendimi i Kryetarit të Njesisë Vendore për Miratimin e Kredisë për Kinancimin e Projekteve të Investimit.....	24
10.a. Shkresë Drejtuar Ministrisë së Financave për Kontrollin e Proçedurave dhe Respektimin e Kufizimeve të Huamarrjes.....	25
10.b. Kontrata e Kredisë Midis Njesisë Vendore dhe Bankës / Institucionit Financiar.....	26
10.c. Marrëveshja e Interceptimit të Financimit.....	38
10.d. Llogaritja e Kufijve Ligjorë të Huamarrjes Vendore.....	44
11. Kontrata e Kredisë dhe Marrëveshja e Interceptimit të Financimit (nëse parashikohet) si në paragrafin 10.b dhe 10.c më sipër, duke reflektuar ndryshimet e kërkuara nga Ministria e Financave).....	46
12. Rishikimi i buxhetit të njesisë vendore duke shtuar fondet nga huaja dhe shpenzimet kapitale që financohen nga këto fonde.....	47
13. Shkresë për Disbursimin e Kredisë.....	48
14. Raportim i situatës në lidhje me huamarrjen vendore tek Ministria e Financave.....	49
15. krijimi i aneksit të borxhit vendor.....	51
3. SITUATA TË TJERA ME TË CILAT MUND TË NDESHEMI GJATË HUAMARRJES VENDORE.....	53

3.1	NË RAST MOSZBATIMI TË KONTRATËS SË HUASË VENDORE NGA ANA E NJËSIVE VENDORE.....	53
3.2	VËNIA NË ZBATIM E MARRËVESHJES SË INTERCEPTIMIT	54
3.3	RASTET E PAAFTËSISË PAGUESE	54

1. HYRJE

Përgatitja e *Dokumenteve & Proçedurave Model për Realizimin e Suksesshëm të Huamarrjes Vendore* erdhi si nevojë e disa prej stafeve teknike të njërive të qeverisjes vendore gjatë eksperiencës së tyre për realizimin e proçedurave të huamarrjes vendore. Që prej fillimit të tij në Shtator 2007, mbështetja e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) u fokusua jo vetëm në drejtim të sigurimit të një rritjeje të qëndrueshme në dhjetë bashkitë partnere të tij, por edhe në krijimin e modeleve të praktikave më të mira me qëllim lehtësimin e këtyre proçeseve në të gjithë Shqipërinë.

Aftësia e njërive të qeverisjes vendore për të financuar projektet e tyre të infrastrukturës dhe projekte të tjera të rëndësishme nëpërmjet huamarrjes nga sistemi bankar privat njihet në të gjithë botën si një e drejtë thelbësore e njërive vendore. Kjo bëri që në shkurt të vitit 2008 në Shqipëri të miratohej ligji “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” si dhe dhe aktet përkatëse nëntor 2008. Në muajin prill 2009 LGPA realizoi dhe vuri në dispozicion të stafeve teknike të të gjitha bashkive dhe komunave në vend, një Manual për Huamarrjen Vendore, kopje të të cilave mund të shkarkohen nga faja internetit e projektit LGPA: www.lgpa.al. Në të njëjtën kohë LGPA asistoi pesë bashki në finalizimin e huave vendore dhe është duke punuar me pesë bashki të tjera për të përfunduar proçedurat e huamarrjes. Huaja e parë e disbursuar (në gusht 2010) i takon bashkisë Korçë e cila po i përdor fondet e marra me anë të kredisë për realizimin e investimeve në zonën këmbësore të qytetit si dhe për përmirësimin e infrastrukturës.

Bazuar në këtë eksperiencë u identifikua nevoja për përgatitjen e një seti dokumentash standarte në zbatim të legjislacionit përkatës, të cilat do të bënin të mundur realizimin e suksesshëm të proçedurave të huamarrjes. Ndër dokumentet më të rëndësishme të përfshira në këtë publikim janë: Kontrata e Kredisë me Bankën; Marrëveshja e Interceptimit si një garanci specifike për kredinë e marrë; Dokumenti i Vlerësimit të Ofertave nga Banka si dhe shkresa të ndryshme dhe dokumente që duhet të përgatiten në faza të ndryshme të këtij proçesi.

Është e rëndësishme të theksohet se dokumentet model të përfshira në këtë publikim përbëjnë vetëm një pikë referimi për bashkitë dhe komunat dhe jo modele të detyrueshme për t’u përgatitur nga ana e tyre. Shpresojmë që përdorimi i këtyre dokumenteve, si një pikë fillestare në negociata, do të ndihmojë në standartizimin e proçesit, eliminimin e ndryshimeve të panevojshme në ofertat e marra dhe në thjeshtëzimin e proçesit për të gjitha palët e përfshira në të. Megjithatë, për çdo rast, këshillohet që seti i propozuar i dokumenteve të bëhet pjesë e negociatave midis njërive vendore dhe bankave apo institucioneve financiare të interesuara. Gjithashtu, gjatë përdorimit të këtyre dokumenteve, duhet të merren parasysh udhëzimet apo manualët që mund të nxirren në vijim nga autoritetet e përkatëse.

Gjatë përgatitjes së këtyre dokumenteve kemi patur konsultime me Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, gjatë të cilave përfaqësuesit e anëtarëve të saj kanë dhënë mendime mbi aspektin ligjor dhe teknik të përmbajtjes së dy prej dokumenteve më të rëndësishme të këtij seti, Kontratës së Kredisë dhe Marrëveshjes së Interceptimit).

Baza ligjore për realizimin e proçedurave të huamarrjes vendore janë Ligji për “Huamarrjen e qeverisjes vendore”, Udhëzimi i Ministrisë të Financave për zbatimin e Ligjit “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, Vendimi i Ministrisë të Financave për disbursimin vjetor të kredisë për vitin 2009, Ligji “Për organizimin dhe funksionim e pushtetit vendor”; Rregullorja e Bankës së Shqipërisë

“Për transparencën e produkteve dhe shërbimeve bankare dhe institucioneve financiare”; si edhe Ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. PROÇESI I HUAMARRJES DHE DOKUMENTET MODEL PËRKATËS

2.1 HAPAT QË REKOMANDOHET TË NDIQEN, AKTORËT QË PËRFSHIHEN DHE DOKUMENTET QË DUHET TË HARTOHEN NË PROÇESIN E HUAMARRJES VENDORE

Në *Manualin për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore* përgatitur nga LGPA/ USAID në Prill 2009 janë shpjeguar në mënyrë të hollësishme procedurat që duhet të ndjekë njësia e qeverisjes vendore për të realizuar marrjen e kredisë nga institucionet private bankare / financiarë brenda apo jashtë vendit si dhe rolin e tyre në përgatitjen e projekt – propozimeve (roli i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak).

Tabela më poshtë jep hapat që duhen ndjekur në vijim të një procedure huamarrjeje, personat përgjegjës, afatet kohore që duhen respektuar dhe dokumentin përkatës ligjor apo teknik që duhet përgatitur.

Nr.	Proçesi / Hapi	Personi Përgjegjës	Afati	Dokumenti që duhet përgatitur
1	Përgatitja e analizave financiare dhe llogaritja e kufijve të huamarrjes	Drejtorja e Financës & grupi i punës së projektit	Gjatë përgatitjes së projekt buxhetit për vitin e ardhshëm buxhetor (zakonisht në dhjetor)	Tabela financiare sipas aneksit A i Udhëzimit të MF, nr. 35, datë 5.11.2008
2	Njoftimi i MF për planet e huamarrjes	Kryetari i njësisë vendore & Drejtorja e Financës	Brenda datës 31 dhjetor të vitit korrent për planet e vitit të ardhshëm buxhetor	Shkresë informuese për MF
3	Hapja e proçesit me bankat / institucionet financiare	Kryetari i njësisë vendore & grupi i punës	Kur gjykohet se duhet filluar proçesi	Shkresë për thithjen e interesit të bankave / institucioneve financiare
4	Ofertat dhe Negocjimi me bankat / institucionet financiare	Kryetari i njësisë vendore & grupi i vlerësimit të ofertave	Sipas afatit të vendosur në shkresën e thithjes së interesit	Shkresa për dërgimin e ofertës teknike – financiare nga ana e bankave / institucioneve financiare të interesuara të marrin pjesë & Përshkrimi i projektit të investimit & Të dhënat financiare të njësisë vendore sipas Aneksit A të Udhëzimit nr 35, datë 5.11.2008 të MF
5	Ngritja e grupit të vlerësimit të ofertave të bankave / institucioneve financiare	Kryetari i njësisë vendore	Menjëherë me nisjen e shkresës së dytë tek bankat / institucionet financiare	Urdhër i Kryetarit të njësisë vendore për ngritjen e grupit të vlerësimit të ofertave të marra nga institucionet financiare të interesuara

Nr.	Proçesi / Hapi	Personi Përgjegjës	Afati	Dokumenti që duhet përgatitur
6	Vlerësimi i ofertave të marra nga bankat / institucionet financiare të interesuara	Grupi i vlerësimit të ofertave	Sipas afatit të vendosur në urdhërin e Kryetarit/ planit të punës	Dokumenti i vlerësimit të ofertave të marra nga bankat / institucionet e interesuara
7	Njoftimi i bankave në lidhje me ofertat e dorëzuara nga ana e tyre	Kryetari i njësisë vendore & grupi i vlerësimit të ofertave	Pas firmosjes së dokumentit të vlerësimit përfundimtar të ofertave	Shkresë për bankat. Letra për bankën fituese dhe letrat për bankat e tjera ku i njoftohet rezultati i vlerësimit në lidhje me ofertën e dhënë për njësinë vendore
8	Njoftimi i publikut për mbledhjen e Këshillit të njësisë vendore ku do të diskutohet kredia	Kryetari i njësisë vendore & grupi i punës / vlerësimit të ofertave	Të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së Këshillit të njësisë vendore	Shkresë për mediat vendore ku njoftohet dhe thirren të marrin pjesë në mbledhjen e hapur të Këshillit të njësisë vendore për diskutimin dhe miratimin e kredisë
9	Mbledhja e Këshillit të njësisë vendore për miratimin e kredisë	Kryetari i njësisë vendore & grupi i punës dhe ai i vlerësimit të ofertave	Ditën e përcaktuar jo më parë sesa 15 ditë nga njoftimi i publikut për të marrë pjesë në mbledhje	Projekt vendimi i Kryetarit për miratimin e kredisë & Relacioni shoqërues & draft kontrata e kredisë & / marrëveshja e interceptimit të financimit me bankën kredituese
10	Aplikimi për kredinë në Ministrinë e Financave	Kryetari i njësisë vendore & grupi i punës	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të kredisë tek autoriteti vendor	Shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për miratimin e kredisë për financimin e projekteve të investimit & Draft Kontrata e Kredisë & të dhënat financiare & marrëveshja e interceptimit & kufizimet ligjore të huasë vendore & të dhënat e konfirmuara nga thesari
11	Firmosja e kontratës së kredisë me bankën / institucionin financiar	Kryetari i njësisë vendore	Pas miratimit nga MF i kredisë dhe sipas afatit të parashikuar nga të dyja palët	Kontrata e kredisë & marrëveshja e interceptimit nëse është parashikuar në kontratë
12	Amendimi i buxhetit vjetor të njësisë vendore	Kryetari i njësisë / Këshilli vendor Drejtorja e Financës	Pas lidhjes së kontratës së huasë me bankën	Buxhet vendor i amenduar duke shtuar fondet nga huaja dhe projektet e investimit që financohen nga këto fonde
13	Disbursimi i kredisë nga banka / institucioni financiar tek njësia vendore	Kryetari i njësisë vendore & grupi i punës / Drejtorja e Financës	Pas firmosjes së Kontratës së Kredisë, ose sipas parashikimeve të Kontratës	Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave & Degës së Thesarit përkatës për disbursimin e kredisë
14	Raportimi i njësisë vendore pranë MF për nivelin e borxhit publik vendor	Kryetari i njësisë vendore / Drejtorja e Financës	Çdo muaj / brenda datës 20 të muajit pasardhës	Shkresë informuese për Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Financave
15	Krijimi i aneksit të borxhit vendor	Kryetari i njësisë vendore / Drejtorja e Financës	Menjëherë me disbursimin e kredisë	Aneksi i buxhetit të njësisë vendore

2.2 DOKUMENTE MODEL QË REKOMANDOHEN PËR ÇDO HAP TË PROÇESIT

Më poshtë jepen dokumentet model që rekomandohet të përgatiten gjatë proçesit të huamarrjes vendore. Theksojmë se këto dokumente janë referues dhe jo domosdoshmërisht të hartueshëm në këtë mënyrë. Ajo çfarë është shumë e rëndësishme të theksojmë për zyrtarët që do të përdorin këtë dokument është se ato duhet të ndjekin radhën e përgatitjes sipas skemës së dhënë më sipër si dhe të zbatojnë afatet ligjore të parashikuara në Ligjin “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” dhe

Udhëzimit të Ministrit të Financave “Për zbatimin e ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore” si dhe akteve të tjera që mund të nxirren nga autoritetet rregulluese.

1. Llogaritja e kufizimeve të huamarrjes
2. Shkresë informuese për Ministrinë e Financave për planifikimin e huamarrjes
3. Shkresë për thithjen e interesit të bankave / institucioneve financiare për të financuar me anë të kredisë projektet e investimit të njësisë vendore
4. Shkresë për dërgimin e ofertës tekniko-financiare nga ana e bankave / institucioneve financiare të interesuara e cila përmban:
 - a. Shkresa që i drejtohet bankës së interesuar e cila ka shprehur interesin në përgjigje të shkresës sipas pikës 3 më sipër
 - b. Të dhënat financiare të njësisë vendore sipas aneksit A, të Udhëzimit të Ministrit të Financave numër 35, datë 5.11.2008 (i njëjtë me dokumentin 1 të treguar më sipër)
 - c. Përshkrimi i projektit të investimit i cili kërkohet të financohet me anë të huamarrjes vendore
5. Urdhër i Kryetarit të njësisë vendore për ngritjen e grupit të vlerësimit të ofertave të marra nga bankat / institucionet financiare të interesuara të financojnë projektet e investimit të njësisë vendore
6. Dokumenti i vlerësimit të ofertave të marra nga bankat / institucionet e interesuara
7. Shkresë për bankat. Banka fituese dhe bankat e tjera që morën pjesë njoftohen mbi rezultatin e vlerësimit të ofertave dhënë për njësinë vendore
8. Njoftim i publikut për mbledhjen e hapur të Këshillit të njësisë vendore për diskutimin dhe miratimin e kredisë
9. Për mbledhjen e këshillit të njësisë vendore përgatiten disa dokumente:
 - a. Projekt vendimi i Kryetarit të njësisë vendore për miratimin e kredisë për financimin e projekteve të investimit
 - b. Relacioni shoqërues i projekt vendimit
 - c. Kontrata e kredisë midis njësisë vendore dhe bankës / institucionit financiar
 - d. Marrëveshja e interceptimit të financimit (nëse kontrata e kredisë e parashikon një gjë të tillë)
10. Shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për miratimin e kredisë për financimin e projekteve të investimit e cila përmban disa dokumente:
 - a. Kërkesa për miratimin e kredisë përkatëse
 - b. Draft kontrata e kredisë (sipas pinës 11 më poshtë)
 - c. Marrëveshja e interceptimit të financimit (nëse është parashikuar në kontratën e kredisë)
 - d. Kufijtë kufizues të borxhit vendor

- e. Të dhënat financiare dhe llogaritja e kufizimeve ligjore të huamarrjes vendore (të dhëna në pikën 1)
11. Kontrata e kredisë & Marrëveshja e interceptimit të financimit (nëse është parashikuar në kontratën e kredisë – sipas modelit të dhënë në pikën 10)
 12. Amendimi i buxhetit vjetor të njësisë vendore, duke shtuar në të fondet nga huamarrja dhe projektet e investimeve nëpërmjet këtyre fondeve
 13. Shkresë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Minitrinë e Financave & Degës së Thesarit përkatës për disbursimin e kredisë
 14. Shkresë drejtuar Drejtorisë së Borxhit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me gjendjen e borxhit publik vendor

1. FORMAT PËR LLOGARITJEN E KUFIZIMEVE TË HUAMARRJES VENDORE

Bashkia/Komuna/Qarku	EKSTRAKT I TË DHËNAVE FINANCIARE TË BUXHETIT LOKAL									
Për efekt të përlogaritjes së kufizimeve të borxhit për kontraktimin e borxhit të ri										
	Buxheti vendor faktik* Viti n-3	Buxheti vendor faktik Viti n-2	Buxheti vendor faktik Viti n-1	Buxheti vendor i miratuar (plan) Viti n	Zbatimi faktik i buxhetit vendor** Viti n	Parashikimi për buxhetin vendor*** Viti n	Parashikimi për buxhetin vendor Viti n+1	Parashikimi për buxhetin vendor Viti n+2	Parashikimi për buxhetin vendor Viti n+3	Parashikimi për buxhetin vendor Viti n+...
I. TË DHËNA MBI BUXHETIN										
<i>Të ardhura Korrente, ndër të cilat:</i>										
1. Taksa Lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Taksa e Pasurisë										
Taksa e Biznesit të Vogël										
Taksa e ndikimit të ndërtimeve mbi infrastrukturën										
Taksë Hoteli										
Takse mbi Xhiron e restoranteve, hoteleve etj.										
Taksa të Përkohshme										
Taksa të tjera										
2. Tarifa Lokale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tarife Pastrimi										
Tarifë për hapësira publike										
Tarifë Tabele										
Tarifë ndriçimi rrugor										
Tarifë gjelbërim										
Tarifë për regjistrimin e bizneseve										
Tarifë reklame										
Tarifë Parkimi										
Tarifa për shërbime të tjera/administrative										
Tarifa për shërbime social/arsimore (arsimi parashkollor, konvikte etj)										
Sporte dhe Kultura										
Të tjera										
3. Të Ardhura Jo-tatimore korrente	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Qira										
Të tjera										
4. TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR										
5. Taksa nga burime (ose administrim) kombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Taksa e regjistrimit të automjeteve										
Taksa e transaksioneve mbi pasuritë e paluajtshme										
Të tjera										
6. SHPENZIME NGA BURIMET E PAKUSHTËZUARA										
<i>Shpenzime operative, ndër të cilat:</i>										
Shërbime të përgjithshme publike (administrata)										
Shërbime publike										
Transporti publik, menaxhimi i transportit rrugor										
Strehimi dhe urbanistika										
Ujësjellës kanalizime										
Arsimi										
Kujdesi social										
Shëndetësia										
Kultura/sporti										
Turizmi/shërbime të tjera ekonomike										
Shërbime të tjera										
II. Të dhëna mbi borxhin										
Kufizimi për shërbimin e borxhit										
Kufizimi për shërbimin e borxhit: 20% i mesatares së shumës (1+2+3+4+5) në vitet n-3, n-2, n-1										
Kufizimi për shërbimin e borxhit: (1+2+3+4+5-6)/1.4 në vitin n-1										
Kufizimi për stokun e borxhit										
Shërbimi i borxhit ekzistues										
Principali										
Interesa										
Komisione, kosto të tjera										
Stoku ekzistues (i pashlyer)										
Stoku i ri										
Stoku i ri i lejueshëm										
Shërbimi i borxhit i ri										
Shërbimi i borxhit i ri i lejueshëm										
*Të dhënat faktike të zbatimit të buxhetit për vitet paraardhëse										
** Të dhënat faktike të zbatimit të buxhetit për muajt paraardhës nga dorëzimi i kërkesës										
*** Rritja vjetore për çdo artikull nuk mund të parashikohet më e lartë se 7% në vit. Nëse parashikohen rritje më të mëdha, ato duhen argumentuar bazuar në të dhëna konkrete.										

2. SHKRESË INFORMUESE PËR MINISTRINË E FINANCAVE PËR PLANET E HUAMARRJES

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Për: Z.

Ministër

Ministria e Financave

Nga: Z.

Kryetar i Bashkisë / Komunës

Bashkia / Komuna

Subjekti: Informacion

I nderuar zoti Ministër,

Bazuar në ligjin numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, neni 7, pika 4 e tij ju njoftojmë se Bashkia Fier ka në planet e saj financiare për vitin 20..... (vitin e ardhshëm buxhetor) marrjen e një huaje nga tregu bankar e brendshëm / huaj bankar / financiar në shumën prejmilionë lekë / Euro / Dollarë amerikanë.

Për të gjitha procedurat e tjera ligjore Ministria juaj do të vihet në dijeni plotësisht sipas ligjit dhe udhëzimit tuaj.

Me respekt,

Z. / Znj.....

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

3. SHKRESË PËR THITHJEN E INTERESIT TË BANKAVE / INSTITUCIONEVE FINANCIARE PËR TË FINANCUAR ME ANË TË KREDISË PROJEKTET E INVESTIMIT TË NJËSISË VENDORE

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.....

Datë,

Subjekti: Shprehje Interesi për financim projekti nëpërmjet huamarrjes vendore.

Për: Banka

Banka

Banka

Të nderuar zotërinj,

Bashkia / Komuna....., ka në planet e saj prioritare ndërtimin e projekteve të infrastrukturës : [vendos emrin / ose përshkruaj shkurtimisht aktivitetet që do të financohen me anë të huasë që kërkohet]

Sipas vleresimit të kryer nga ana jonë, ndërhyrja që kërkojmë të kryejmë, kërkon një financim prej rreth milion Lekë / Euro / Dollarë amerikanë.

Kjo shumë është jashtë kapaciteteve buxhetore të bashkisë për tu realizuar në një vit buxhetor. Bashkia jonë ka përlogaritur kufijtë e saj ligjor (sipas ligjit “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” dhe udhëzimit përkatës) dhe rezulton se shuma prej [.....] milion lekë është brenda kufijve ligjorë të bashkisë / komunës tonë.

Me këtë letër dëshirojmë tërheqjen e shprehjes së interesit të bankave që duan të hyjnë një marrëveshje huaje me bashkinë tone duke qenë se sipas ligjit bashkia / komuna është e detyruar të bëjë publike qëllimin e saj në sa më shumë aktorë të interesuar.

Dëshirojme të theksojmë se aktualisht bashkia jonë është në procesin e hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, gjë që bën të nevojshme përshpejtimin e vendimarrjes nga ana jonë në lidhje me identifikimin e treguesve kryesorë të një huaje të mundshme siç janë; maturimi (periudha për të cilën do të merret huaja); norma e interesit; elementet e garancisë; komisionet kontraktuale etj.

Theksojmë se këto elementë të huasë do të jenë pjesë e negociatave më teknike që do të zhvillohen midis bankave që do të dorëzojnë një ofertë zyrtare.

Për të qenë sa më korrektë me procedurat e buxhetimit për vitin e ardhshëm kemi vendosur që afati maksimal për shprehjen e interesit është data20.... Të gjitha bankat e interesuara (pra që do të shprehin interesin pranë bashkisë / komunës tonë brenda kësaj date) janë të ftuara të kërkojnë gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me këtë projekt dhe treguesit financiarë të bashkisë / komunës (personi i kontaktit është Z/Znj. email: personkontakti@bashkia.com tel:).

Z. / Znj.....

K R Y E T A R

BASHKIA /KOMUNA.....

4.A. SHKRESË PËR DËRGIMIN E OFERTËS TEKNIKO-FINANCIARE NGA ANA E BANKAVE / INSTITUCIONEVE FINANCIARE TË INTERESUARA

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.....

Datë,

Lënda: Dërgim i ofertës tekniko – financiare për financimin e projekteve të investimit me anë të kredisë bankare

Për: Banka.....

I nderuar Z./Znj.

Duke ju falenderuar për interesin që paraqisni për të qënë pjesë e financimit me anë të kredisë për disa projekteve investimi në bashkinë / komunën....., ju ftoj në vijim të shkresës tonë me nr protokollit, datë, për shprehje interesi dhe tuajës me nr. protokollit datë , të dorëzoni pranë Bashkisë / Komunës në sekretarinë e Kryetarit të Bashkisë / Komunës brenda datës, ofertën tekniko – financiare për të bërë të mundur një gjykim të parë të synimeve tuaja.

Për t'ju mundësuar një bazë përlllogaritjesh nga ana juaj të ofertës në fjalë bashkëlidhur me këtë letër do të gjeni të dhënat financiare të Bashkisë / Komunëspër periudhën 20XX – 20YY, të cilat janë edhe treguesit financiarë të kërkuar nga Ministria e Financave në të tilla procedura si dhe përshkrimin e detajuar të projekteve që synohet të financohen me anë të kësaj kredie.

Ju informojmë që mbas vlerësimit të të gjitha ofertave tekniko – financiare që do të dorëzohen në adresën tonë, ju do të kontaktoheni për negociata dhe diskutime të mëtejshme. Për informacione më të detajuara në lidhje me këtë projekt dhe financave të bashkisë / komunës tonë lutem kontaktoni Z./ Znj.(pozicioni i personit të kontaktit).

Me respekt,

Z./ Znj.....

K R Y E T A R

BASHKIA /KOMUNA.....

4.B. TË DHËNA FINANCIARE PËR NJËSINË VENDORE (SI PIKA 1 MË SIPËR)

4.C. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË INVESTIMIT QË DO TË FINANCOHET ME ANË TË HUAMARRJES VENDORE

Titulli i Projektit “Ndërtimi i rrugës”

Ritmet e zhvillimit të vendit tonë, sidomos të sektorit të turizmit për qytetin e, kërkojnë investime të vazhdueshme si për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe të ndërtimit të rrugëve të reja, për t’iu përgjigjur trafikut gjithmonë në rritje në segmentin, Pikërisht, rruga në fjalë do të jetë në prespektivë pjesë e rrugës nacionale, duke i shërbyer në të ardhmen qarkullimit rrugor të zonave turistike të këtij rajoni. Ky segment rrugor është një nga akset më të rëndësishme për qytetin tonë. Ai parashikohet të ketë një fluks të madh trafiku dhe do sjellë një rikonceptim urban në këtë rajon.

Projekti është hartuar në përputhje me standartet dhe kushtet teknike të projektimit për rrugë të kategorisë së parë. Parashikohet ndërtimi i dy trotuareve me gjerësi 2.5m dhe gjelbërim me pemë çdo 4m. Trotualet do të jenë të veshur me pllaka kuarci. Gjithashtu është parashikuar sinjalistika horizontale dhe vertikale, si dhe vendosja në dy krahët e shtyllave të reja metalike të ndriçimit. Projekti përfshin rrjetin e ujërave të bardha dhe atë të ujërave të zeza, si dhe ndërtimin e linjave rezervë për Elektrimin dhe Telekomimin.

Si përfundim themi se me ndërtimin e kësaj rruge arrihen parametrat e mëposhtëm:

- Me seksionet e rrugëve të projektuara menaxhojmë shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve.
- Rritet siguria e trafikut dhe kalimtarëve duke ndërtuar sinjalistikën përkatëse.
- I jepet prioritet transportit të mjeteve të shërbimit duke krijuar për herë të parë korsinë e emergjencave, autobuzëve, ambulancave.
- Krijohet mundësia e parkimit të organizuar në vendet më të afërta të objekteve sociale si shkollat, bizneset, etj.
- Garantohet siguria që banorët e qytetit tonë të kenë kushte normale të kalimit të rrugëve kryesore nga një krah në krahun tjetër me sinjalistikë, gjelbërim dhe ndriçim bashkëkohor.

Preventiv përmblidhës i ndërtimit të rrugës:

Nr.	Emërtimi	Vlera (lek)
1	Preventivi i rrugës
2	Preventivi i ujërave të zeza
3	Preventivi i ujërave të shiut
4	Preventivi i rrjetit elektrik
5	Preventivi i gjelbërimit
6	Preventivi i sinjalistikës
	Shuma Totale

5. URDHËR I KRYETARIT TË NJËSISË VENDORE PËR NGRITJEN E GRUPIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË MARRA NGA BANKAT / INSTITUCIONET FINANCIARE

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Urdhër

Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave financiare nga bankat e interesuara për financimin me anë të huasë të projektit “.....”.

Me qëllim shqyrtimin teknik të ofertave të marra nga ana e bankave të nivelit të dytë që kanë shprehur interesin për financimin me anë të huasë të projekteve të infrastrukturës “.....” ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave të marra.

Në këtë komision marrin pjesë:

1. – Kryetar i Komisionit
2. – Anëtar
3. – Anëtar
4. – Anëtar
5. – Anëtar

Grupi i punës duhet të përgatisë analizën financiare të ofertave të marra dhe raportin e vlerësimit të ofertave për prezantim në Këshillin Bashkiak / Komunal.

Ngarkohet Drejtoria e Financës të parashikojë brenda buxhetit të vitit 20..... fondet përkatëse për shërbimin e borxhit sipas vlerësimit të ofertës më të mirë të marrë dhe të përgatisë dokumentin informues për Ministrinë e Financave mënjëherë me miratimin e kredisë në Këshillin Bashkiak / Komunal si edhe gjithë dosjen për miratimin e kredisë për Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore.

Z. / Znj/.....

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

6. DOKUMENTI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË MARRA NGA BANKAT / INSTITUCIONET E INTERESUARA

BASHKIA / KOMUNA

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Vendim

Vlerësim i rezultatit të ofertave të marra nga Bankat e interesuara për financimin me anë të huasë së projekteve të infrastrukturës në Bashkinë / Komunën

Në datën , Komisioni i vlerësimit në përbërje të të cilit janë:

1. – Kryetar i Komisionit
2. – Anëtar
3. – Anëtar
4. – Anëtar
5. – Anëtar

Në bazë të shkresës së kryetarit të bashkisë me nr. Prot, datë.....për tërheqjen e interesit të bankave për të financuar me anë të huasë projektin “.....” pranë Bashkisë / Komunës.....u dorëzuan 5 shprehje teknike interesi të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- Banka
- Banka
- Banka
- Banka
- Banka

Ofertat e Bankave dorëzuar përpara negociatave teknike								
Bankat e interesuara të kreditojnë Bashkinë / Komunën.....	Principali / Huaja	Kohëzgjatja	Interesi vjetor	Komisione bankare	Penalitetet	Kolateral	Mënyra e shlyerjes	Parashikime të tjera
Banka 1 / Alternativa 1	113 000 000 Leke	60 muaj (5 vjet)	BTh 12 mujore + 0.8% Minimumi i interesit 8.5%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Bank 1 / Alternativa 2	113 000 000 Leke	84 muaj (7 vjet)	BTh 12 mujore + 0.9% Minimumi i interesit 8.5%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Bank 1 / Alternativa 3	113 000 000 Leke	120 muaj (10 vjet)	BTh 12 mujore + 1% Minimumi i interesit 8.5%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Banka 2	113 000 000 Leke	5 - 6 vjet	BTh 12 mujore + 1.9 % Minimumi i interesit 10%	???	ska kerkuar	Interceptimi i financimit	???	
Banka 3	113 000 000 Leke	7 vjet & 6-12 muaj grace ne varesi te kerkeses se Bashkise	BTh 12 mujore + 0.5%	komision administrimi = 0.5% e kredise	* Per vonese ne pagesen e kesteve 5% mbi interes	Interceptimi i te ardhurave te bashkise	???	*Jo me pak se 70% e aktivitetit te bashkise te kanalizohet nepermjet kesaj banke ** pagat e personelit te bashkise te kanalizohen tek kjo banke
Banka 4	113 000 000 Leke	Deri ne afatin e investimit	BTh 12 mujore + 1.0 %	komision angazhimi = 0.25% e shumes se kredise	???	???		
Banka 5	113 000 000 Leke	5; 6; 7 vjet	BTh 12 mujore + 1.5%	kosto administrative = 0.5%	*Penalitetet per likuidim total te kredise se mbetur para afatit eshte 2% e shumes se mbetur te kredise *Penalitetet per likuidim pjesor te kredise eshte 2% e shumes se likuiduar	Interceptimi i financimit + garancia e USAID-it	mujore = principal + interes	

Në mënyrë të përmbledhur ofertat e marra si më sipër paraqiten:

	Bankat e interesuara të kreditojnë Bashkinë / Komunën	Norma BTh 12 mujore	Interesi vjetor	Interesi real ne vitin e parë (perfshihen komisionet)	Komisioni ne Leke	Shuma e ofruar e Huase
2	Banka 1 / Alternativa 1	8.35	9.15	9.35	226,000	113,000,000
3	Bank 1 / Alternativa 2	8.35	9.25	9.45	226,000	113,000,000
4	Bank 1 / Alternativa 3	8.35	9.35	9.55	226,000	113,000,000
6	Banka 2	8.35	10.25	???	???	113,000,000
1	Banka 3	8.35	8.85	9.35	565,000	113,000,000
4	Banka 4	8.35	9.35	9.60	282,500	113,000,000
5	Banka 5	8.35	9.85	10.35	565,000	113,000,000

Të përkthyer në terma konkretë monetarë për financat e bashkisë këto oferta janë:

Ofertat para									
Vite	Periudha	Kufizimi i shërbimit të borxhit	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 1	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 2	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 3	Kestet sipas Banka 2	Kestet sipas Banka 3	Kestet sipas Banka 4	Kestet sipas Banka 5
1	2010	33,613	28,473	22,215	17,661	25,857	22,279	24,961	22,971
2	2011	65,919	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
3	2012	70,165	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
4	2013	77,006	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
5	2014	80,856	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
6	2015	84,899		21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
7	2016	89,144		21,989	17,435		21,714		22,406
8	2017	93,601			17,435				22,406
9	2018	98,281			17,435				
10	2019	103,195			17,435				
11	2020	108,355							
12	2021	113,773							
13	2022	119,461							
14	2023	125,434							
15	2024	131,706							
	Totali	1,395,409	141,462	154,151	174,577	152,319	152,561	148,356	179,815

[Konkluzion]

Meqënëse ofertat e dorëzuara ishin shumë të përgjithshme, u vendos të negocjohej teknikisht vetëm me dy nga 5 bankat të cilat ofronin edhe normat më të mira të interesit dhe kushte të tjera të lidhur me ofertën. Bank 3 nuk u konsiderua si ofertë e dobishme edhe pse kishte normën më të ulët të interesit pasi oferta e kësaj banke kushtëzonte realizimin e pagesave të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë, si edhe nuk ishte e interesuar të negocjonte më tej në lidhje me ofertën e dhënë për t'a rishikuar atë.

Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave realizuan negocjatat teknike me bankat përkatëse. Të gjithë përfaqësuesve të bankave të mësipërme iu bë një përshkrim më i detajuar i projekteve që kërkohet të financohen me anë të huasë bankare si dhe iu kërkua informacion më i detajuar në lidhje me ofertat e paraqitura prej tyre që kanë të bëjnë me afatin e maturimit, normën e interesit të aplikuar; kushtet e garancisë; planin e pagesave dhe komisionet bankare.

Në vijim të këtyre negocjatave teknike me dy bankat e mësipërme u ofruan këto oferta të reja financiare më poshtë jepet situata me të gjitha ofertat e marra fillimisht dhe ato të rinegocjuara:

Ofertat e Bankave dorëzuar - Pas Negocjatave teknike								
Bankat e interesuara të kreditonjë Bashkinë / Komunën.....	Principali / Huaja	Kohëzgjatja	Interesi vjetor	Komisione bankare	Penalitetet	Kolateral	Mënyra e shlyerjes	Parashikime të tjera
Banka 1 / Alternativa 1	113 000 000 Leke	60 muaj (5 vjet)	BTh 12 mujore + 0.8%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Bank 1 / Alternativa 2	113 000 000 Leke	84 muaj (7 vjet)	BTh 12 mujore + 0.9%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Bank 1 / Alternativa 3	113 000 000 Leke	120 muaj (10 vjet)	BTh 12 mujore + 1%	komision disbursimi = 0.2% shuma e kredise	ska kerkuar	Interceptimi i financimit; garanci me prona fizike;	keste tremujore	
Banka 2	113 000 000 Leke	5 - 6 vjet	BTh 12 mujore + 1.9 % Minimumi i interesit 10%	???	ska kerkuar	Interceptimi i financimit	???	
Banka 3	113 000 000 Leke	7 vjet & 6-12 muaj grace ne varesi te kerkeses se Bashkise	BTh 12 mujore + 0.5%	komision administrimi = 0.5% e kredise	* Per vonese ne pagesen e kesteve 5% mbi interes	Interceptimi i te ardhurave te bashkise	???	*Jo me pak se 70% e aktivitetit te bashkise te kanalizohet nepermjet kesaj banke ** pagat e personelit te bashkise te kanalizohen tek kjo banke
Banka 4	113 000 000 Leke	Deri ne afatin e investimit	BTh 12 mujore + 1.0 %	komision angazhimi = 0.25% e shumes se kredise	???	???		
Banka 5	113 000 000 Leke	5; 6; 7 vjet	BTh 12 mujore + 1.5%	kosto administrative = 0.5%	*Penalitetet per likuidim total te kredise se mbetur para afatit eshte 2% e shumes se mbetur te kredise *Penalitetet per likuidim pjesor te kredise eshte 2% e shumes se likuiduar	Interceptimi i financimit + garancia e USAID-it	mujore = principal + interes	

Për ti bërë të krahasueshme këto oferta kemi përgatitur tabelën e mëposhtme:

Bankat e interesuara të kreditonjë Bashkinë / Komunën	Norma BTh 12 mujore	Interesi vjetor	Interesi real ne vitin e parë (perfshihen komisionet)	Komisioni ne Leke	Shuma e ofruar e Huase
2 Banka 1 / Alternativa 1	8.17	8.97	9.17	226,000	113,000,000
3 Bank 1 / Alternativa 2	8.17	9.07	9.27	226,000	113,000,000
4 Bank 1 / Alternativa 3	8.17	9.17	9.37	226,000	113,000,000
6 Banka 2	8.17	10.07	???	???	113,000,000
1 Banka 3	8.17	8.67	9.17	565,000	113,000,000
4 Banka 4	8.17	9.17	9.42	282,500	113,000,000
5 Banka 5	8.17	9.67	10.17	565,000	113,000,000

Grupi i vlerësimit analizoi ofertat përfundimtare (përveç ofertave të para të dorëzuara - si rezultat i negociatave teknike me bankat e interesuara) të marra nga 5 banka që shprehën interesin të financojnë me anë të huasë afatgjatë fondin e plotë për ndërtimin e disa projekteve të infrastrukturës së qytetit duke u bazuar në të gjithë elementët e huasë së ofruar (afat maturimi; normë interesi; komisione bankare) si dhe në planin vjetor të shërbimit të huasë bankare (principal+interes) si edhe në planin e rishikuar të realizimit të shërbimit të pagave të personelit.

Për rrjedhojë ofertat e bankave paraqiten si më poshtë:

Pas rinegocjimit									
Vite	Periudha	Kufizimi i shërbimit të borxhit	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 1	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 2	Kestet sipas Banka 1 / Alternativa 3	Kestet sipas Banka 2	Kestet sipas Banka 3	Kestet sipas Banka 4	Kestet sipas Banka 5
1	2010	33,613	28,473	22,215	17,661	25,857	22,279	24,961	22,971
2	2011	65,919	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
3	2012	70,165	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
4	2013	77,006	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
5	2014	80,856	28,247	21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
6	2015	84,899		21,989	17,435	25,292	21,714	24,679	22,406
7	2016	89,144		21,989	17,435		21,714		22,406
8	2017	93,601			17,435				22,406
9	2018	98,281			17,435				
10	2019	103,195			17,435				
11	2020	108,355							
	Totali	905,035	141,462	154,151	174,577	152,319	152,561	148,356	179,815

Për të realizuar një analizë të saktë të ofertave të marra u bë vlerësimi i kostos së kredisë sipas metodës së vlerës aktuale e cila paraqitet si më poshtë:

Vlera Aktuale e ofertave të marra									
Vite	Periudha	norma e skontimit (1+r) ⁿ	PV te kestet sipas Banka 1 / Alternativa 1	PV te kestet sipas Banka 1 / Alternativa 2	PV te kestet sipas Banka 1 / Alternativa 3	PV te kesteve te Banka 2	PV te kesteve te Banka 3	PV te kesteve te Banka 4	PV te kesteve te Banka 5
1	2009								
2	2010	1.095	26,003	20,288	16,129	23,614	20,346	22,796	20,978
3	2011	1.199025	23,558	18,339	14,541	21,094	18,109	20,582	18,687
4	2012	1.31293238	21,515	16,748	13,280	19,264	16,538	18,797	17,066
5	2013	1.43766095	19,648	15,295	12,127	17,593	15,103	17,166	15,585
6	2014	1.57423874	17,943	13,968	11,075	16,066	13,793	15,677	14,233
7	2015	1.72379142	-	12,756	10,114	14,672	12,596	14,317	12,998
8	2016	1.88755161	-	11,650	9,237	-	11,504	-	11,871
9	2017	2.06686901	-	-	8,436	-	-	-	10,841
10	2018	2.26322156	-	-	7,704	-	-	-	-
11	2019	2.47822761	-	-	7,035	-	-	-	-
11	2020	2.71365924	-	-	-	-	-	-	-
	Totali		108,667	109,045	109,678	112,304	107,990	109,334	122,259
	Norma e interesit Obl 2 vjeçare		0.095	0.095	0.095	0.095	0.095	0.095	0.095
			2	3	5	6	1	4	7

Në mënyrë të përmblëdhur, ofertat më të mira janë të klasifikuara më poshtë:

Huaja 113 milionë Lekë Bankat e Interesuara		Kostoja e huasë deri në fund të maturimit	
1	Banka 3	152,561	
2	Banka 1 / Alternativa 1 & 2 & 3	141,462	154,151
3	Banka 4	148,356	
4	Banka 2	152,319	

Banka që ka dhënë ofertën më të lirë është Banka 3 e cila kërkon për një hua prej 113,000,000 Lekë të shlyhen në total në fund të periudhës 7 vjeçare gjithsej 152,561,000 Lekë (përfshirë komisioni i angazhimit), dhe oferta e dytë më e mirë është ajo e Banka 1 me afat maturimi 5 vjeçar e cila kërkon për një hua prej 113,000,000 Lekë të shlyhen në total në fund të periudhës 5 vjeçare gjithsej 141,462,000 Lekë (përfshirë komisioni i angazhimit).

Duke u bazuar në komponentë të tjerë teknikë të ofertës së këtyre dy bankave ku përfshihet edhe shërbimi i pagave të punonjësve (lutem referojuni dosjes me ofertat e marra nga bankat e interesuara) dhe kur dimë nga eksperiencia e deritanishme që aplikon Banka 3 për shërbimin e pagave të punonjësve kundrejt një komisioni për çdo transaksion nga më të lartit në tregun bankar, komisioni i vlerësimit të ofertave e përjashtoi këtë bankë nga lista e ofertave më të mira, pasi nuk mund të bazojmë kthimin e huasë në kurriz të pagave të punonjësve të institucioneve të bashkisë / komunës sonë. Nga ana tjetër banka e dytë më e mirë në listë Banka 1 nuk ka vendosur pas negocjimit as edhe një kusht (kjo bankë pas negocjatave e hoqi kushtin e normën minimale të interesit të kredisë prej 8.5% në vit). Ndër tre ofertat që ka dhënë kjo bankë ajo me afat maturimi 5 vjeçar ka një kthim huaje më të ulët por ndërkohë objektivi ynë është që nëpërmjet kësaj huaje të mund të kthejmë sa më pak hua nga fondi vjetor i investimeve për të lënë më shumë hapësirë për investime të tjera në vite. Për këtë arsye u gjykua se oferta më e mirë e marrë nga Banka 1 është ajo me afat maturimi 7 vjeçar, ku për një shumë prej 113 milionë lekë duhet të kthehen mbrapsh për bankën për 7 vjet së bashku me gjithë komisionet bankare në total 154,15 milionë lekë.

Në mënyrë të detajuar kushtet e ofertës së huasë janë:

- Banka kredituese “Banka 1”
- Shuma e huasë 113 milionë lekë;
- Norma vjetore e interesit në lekë Bono Thesari 12 mujore + 1%
- Maturimi 7 vjet; dhe kushtet e kthimit të saj janë pagesa e principalit dhe interesit çdo tre muaj;
- Qëllimi për të cilin merret huaja është financimi i projektit të infrastrukturës
- Garanci për kthimin e huasë vendosen të ardhurat e pakushtëzuara të bashkisë / komunës;
- Komision angazhimi në masën 0.2% mbi principalin;
- Shlyerja e huasë në këste tremujore.

Kryetari i Bashkisë do të vazhdojë procedurat e mëtejshme për miratimin e saj në Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave.

Z./Znj.....

K R Y E T A R i KOMISIONIT

BASHKIA / KOMUNA.....

7. SHKRESË BANKAVE NË LIDHJE ME OFERTËN E DHËNË PËR NJËSINË VENDORE

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.
...../...../20.....

Datë

Për: Z.
Banka

Nga: Z.
Kryetar i Bashkisë / Komunës
Bashkia / Komuna

Lënda: Mbi ofertën tuaj për financimin me anë të huasë të projekteve të investimit

I nderuar Z./ Znj.

Duke ju falenderuar për interesin tuaj për të financuar me anë të kredisë projektet e investimit të bashkisë / komunës sonë gjatë vitit 20... - 20..., ju informojmë se oferta juaj është oferta [më e mirë]¹ e dorëzuar pranë institucionit tonë.

Në mënyrë që të përshpejtojmë me procedurat e mëtejshme ligjore për të mundësuar kredinë në fjalë lutem dërgoni një draft kontratë kredie, dokument i cili duhet të bëhet pjesë e materialeve për miratim në Këshillin bashkiak / komunal dhe më tej nëse miratohen prej këtij të fundit në Ministrinë e Financave.

Duke shpresuar se institucionet përkatëse ligjore do të miratojnë këtë projekt kredie, mbetemi në pritje të një dokumenti zyrtar tuajit mbi kontratën e kredisë dhe parashikime të tjera ligjore sipas negociatave të realizuara.

Me respekt,

Z./Znj.....

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

¹ Ky është modeli shkresës dërguar bankës e cila është vlerësuar se ka dhënë ofertën me të mirë. Bankave të tjera i njoftohet fakti se oferta e tyre nuk është konsideruar më e mira e dorëzuar dhe falenderohet për bashkëpunimin duke shpresuar në raste të tjera pune me të.

8. NJOFTIM I PUBLIKUT PËR MBLEDHJEN E HAPUR TË KËSHILLIT TË NJËSISË VENDORE PËR DISKUTIMIN DHE MIRATIMIN E KREDISË

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Njoftim

Mbi mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak / Komunal

Të nderuar Qytetarë,

Ju njoftojmë se Bashkia / Komuna jonë duke analizuar me shumë seriozitet zbatimin e prioriteteve qytetare dhe nevojave të komunitetit dhe zhvillimit të mëtejshëm të qytetit dhe biznesit vendas ka filluar procedurat e marrjes së kredisë në shumën prej milionë lekë nga tregu bankar brenda vendit për financimin e projekteve të rëndësishme që janë: (i) (ii)..... dhe (iii).....

Këto projekte infrastrukture do të përmirësojnë në mënyrë të rëndësishme infrastrukturën e qytetit në zonën e për rrjedhojë jetën e banorëve të kësaj lagjieje do të nxisin aktivitetin e biznesit e për rrjedhojë do të çojnë edhe në rritjen e të ardhurave të bashkisë/ komunës sonë.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak / Komunal e cila do të mbahet në datën do të shqyrtohet për miratimin kjo kredi. Të dhënat kryesore të kësaj kredie janë:

- Shuma e huasë milionë lekë;
- Norma vjetore e interesit në lekë Bono Thesari 12 mujore +%
- Forma e huasë është hua nga tregu bankar;
- Maturimi; dhe kushtet e kthimit të saj janë pagesa e principalit dhe interesit çdo.....;
- Qëllimi për të cilin merret huaja është financimi i projekteve të infrastrukturës
- Garanci për kthimin e huasë vendosen të ardhurat e pakushtëzuara të bashkisë /
- Për marrjen e kredisë janë respektuar të gjitha kriteret kufizuese të borxhit sipas kreut IV të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore;
- Koha e dobishme e përdorimit tëqë financohet nga kjo hua është vjet.

Ju njoftojmë se kjo mbledhje është e hapur për publikun dhe kemi nderin t’ju ftojme të merrni pjesë në mënyrë sa më aktive.

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

9. PROJEKT VENDIMI I KRYETARIT TË NJËSISË VENDORE PËR MIRATIMIN E KREDISË PËR KINANCIMIN E PROJEKTEVE TË INVESTIMIT

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë

...../...../20.....

Projekt Vendim²

Për Miratimin e Kredisë Bankare për Financimin e Projektit “.....”

Bazuar në Ligjin numër 8652, datë 31.07.2000, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” dhe Ligjin numër 9869, datë 4.02.2008, “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” neni 7, pikat 1 dhe 2 të tij dhe Udhëzimit numër 35, datë 5.11.2008 të Ministrit të Financave “Për Zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 4.02.2008, “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore” Kryetari i Bashkisë / Komunës i propozon Këshillit Bashkiak / Komunal:

Të miratojë marrjen e kredisë bankare për financimin e projektit me këto të dhëna tekniko-financiare:

- a. Qëllimi për të cilin merret huaja është financimi i projektit “.....”;
- b. Shuma e huasë milionë lekë;
- c. Norma vjetore e interesit në lekë do të jetë %;
- d. Forma e huasë është hua nga tregu bankar / Banka
- e. Maturimi vjet;
- f. Mënyra e kthimit të saj është shlyerje mujore / vjetore e principalit dhe interesit sipas skemës së amortizimit të propozuar nga banka fituese pjesë e kontratës së huasë;
- g. Garanci për kthimin e huasë vendosen të ardhurat e pakushtëzuara të bashkisë dhe / ose
- h. Janë respektuar të gjitha kriteret kufizuese të borxhit sipas kreut IV të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, të cilat janë:
 - kufizimi i stokut - huaja e marrë të jetë maksimumi milionë lekë dhe
 - shërbimi i borxhit për vitin 20..... të jetë maksimumi milionë lekë.
- i. Koha e dobishme e përdorimit të rrugës që financohet nga kjo kredi është 15 vjet.

Z./Znj.....

Z./Znj.....

K R Y E T A R

Sekretar i Këshillit

BASHKIA / KOMUNA

BASHKIA / KOMUNA.....

² Ky projekt vendim shoqërohet me një relacjon shpjegues mbi kredinë që kërkohet të merret, projektet të cilat do të financohen me anë të kësaj kredie, koston e tyre, impaktin në komunitet etj, procesin e realizuar nga njësia vendore për marrjen e saj. Operat e marra nga bankat / institucionet financiare. Përzgjedhjen e ofertës më të mirë. Dokumenta të cilat janë hartuar më parë për arritjen deri këtu. Sugjerohet të merret për bazë dokumenti i vlerësimit të ofertave si pjesë e relacionit.

**10.A. SHKRESË DREJTUAR MINISTRISË SË FINANCAVE PËR KONTROLLIN E
PROÇEDURAVE DHE RESPEKTIMIN E KUFIZIMEVE TË HUAMARRJES**

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Për: **Z.**
Ministër
Ministria e Financave

Nga: **Z.**
Kryetar i Bashkisë / Komunës
Bashkia / Komuna

Subjekti: **Kërkesë për miratim të kredisë nga Sistemi Bankar për financimin e
projekteve të infrastrukturës së qytetit³**

I nderuar zoti Ministër,

Bazuar në ligjin numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e qeverisjes Vendore” neni 7, pika 4 e tij dhe Udhëzimit tuaj numër 35, datë 5.11.2008 neni 3, pika 8 e tij lutem ju njoftojmë se Bashkia / komuna jonë duke vlerësuar me seriozitet nevojën emergjente për realizimin e disa projekteve të investimit në qytetin tonë ka ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për kontraktimin e një kredie nga tregu bankar shqiptar. Lutem gjeni bashkëlidhur me këtë dokument përshkrimin e nevojës së zbatimit të këtij projekti; kërkesat ligjore në lidhje me informimin e institucionit tuaj mbi këtë kredi si:

1. Kopje të vendimit të këshillit bashkiak / komunal për miratimin e kontratës së kredisë;
2. Draft kontratën e kredisë me institucionin financiar nga e cila është vendosur të merret kredia;
3. Të ardhurat dhe shpenzimet operative të tre viteve të mëparshme financiare (2006-2009) si dhe konfirmimet e këtyre të dhënave nga dega e thesarit
4. Koston e shërbimit të borxhit për vitin fiskal aktual, përfshirë koston e parashikuar të huasë së re

Duke shpresuar se ju do ta gjykoni të rregullt këtë procedurë nga ana jonë, mbetemi në pritje të një konfirmimi nga ana juaj për bërjen efektive të kësaj kredie.

Me respekt,

Z./Znj.....

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

³ Sikurse citohet në këtë shkresë zyrtare ajo shoqërohet nga një sërë dokumentash të tjerë të cilët i gjeni në këtë dokument model, përveç analizës së koston së shërbimit të kësaj kredie e cila gjendet në vijim të këtij materiali. Tërheqim vëmendjen se ky është një dokument referues, por nga eksperiencia jonë deri më sot ka njësi vendore që përveç këtyre dokumentave kanë bërë pjesë të kësaj kërkesë edhe zbardhjen e vendimit të këshillit bashkiak / komunal nga Prefekti.

10.B. KONTRATA E KREDISË MIDIS NJËSISË VENDORE DHE BANKËS / INSTITUCIONIT FINANCIAR

Logo e Bashkisë / Komunës

Logo e Bankës / Institucionit Financiar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Numri i Klientit: _____

DHOMA E NOTERËVE

Numri i Kredisë: _____

NR. _____ REP.

NR. _____ KOL.

KONTRATË KREDIE⁴

Në _____, sot më datë _____, përpara meje noter/es _____, u paraqitën:

KREDIDHËNËSI: Banka _____ sh.a, person juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi të Subjektit (NIPT) _____, në datën _____, me seli në Rruga _____, Tiranë, këtu e më poshtë i quajtur **Kredidhënësi**, liçensuar nga Banka e Shqipërisë me Liçensën Nr.____, datë _____, e përfaqësuar nga Z. _____, shtetas _____, lindur ne _____, me _____, me pasaportë/leternjoftim nr. _____, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

dhe

KREDIMARRËSI: BASHKIA / KOMUNA _____, NJËSI E QEVERISJES VENDORE sipas legjislacionit Shqiptar, me adrese në _____, e përfaqësuar nga _____, me cilësinë e Kryetarit të Bashkisë / Komunës, lindur më datë _____, mbajtës i pasaportës/leternjoftimit me nr._____, i autorizuar me vendimin nr.____ datë _____ të Këshillit Bashkiak / Komunal të _____ këtu e më poshtë i quajtur **Kredimarrësi**.

Palët kanë rënë paraprakisht dakort që të lidhet kjo kontratë bazuar ne Ligjin Nr.9869, date 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore", në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkionimin e Qeverisjes Vendore", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.35, datë 05.11.2008, me kushtet e mëposhtme:

[Shënim]

Në këtë seksion përcaktohen palët e përfshira në kontratën e kredisë. Bazuar në ligjin numër 9869, datë 4.2.2008 palët mund të jenë njësia vendore (bashki/ komunë/qark) dhe institucioni financiar

⁴ Drafti i Kontrates se Kredise eshte konceptuar brenda kuadrit te nje kontrate kredie, ne te cilen ripagimi i kesteve te kryegjese dhe interesit kontraktor eshte me keste mujore/tre mujore etj, sipas planit te pagesave. Duhet mbajtur parasysh se ekzistojnë edhe klauzola kontraktore specifike/draft marreveshje overdrafti apo linje tjeter kredie, pasi sipas perkufizimit te dhene ne nenin 3 pika 5 te Ligjit nr. 9869, date 4.2.2008 "Per huamarrjen e qeverisjes vendore" ne marreveshjet financimit perfshihen edhe keto tipe kreditimesh bankare.

(bankë / institucion financiar ndërkombëtar etj) ose një njësi ekonomike në varësi të njësisë vendore dhe institucioni financiar.

NENI 1: PËRKUFIZIME

Në kuptim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, termat e mëposhtëm kanë kuptimin sa më poshtë jepet:

- Ministria e Financave – është Ministria e Financës së Republikës së Shqipërisë;
- Palët – nënkupton bashkërisht Kredihënësin dhe Kredimarrësin;
- Kredia – nënkupton çdo sasi të hollash që Kredimarrësi detyrohet t'i shlyejë Kredihënësit, sipas kushteve të kësaj Kontrate dhe që përfshin kryegjënë, interesin, kamatë vonesat, komisionin e angazhimit, si dhe çdo komision tjetër i pagueshem ndaj Kredihënësit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;
- Ditë Pune - do të thotë çdo ditë në të cilën bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë janë të hapura për kryerjen e transaksioneve normale bankare;
- Borxh - nënkupton shumën e kredive të marra në tregun bankar, financiar me kusht ripagimi, me ose pa interes, të cilat janë në ngarkim të Kredimarrësit.
- Shërbimi i Borxhit - nënkupton pagesat që duhet të kryhen në çdo vit fiskal për kryegjënë, interesat, zbritjet dhe pagesat e tjera që rrjedhin nga huatë, përfshirë edhe shpenzimet e lidhura me të.
- Kontrata e Kredisë - është kjo Kontratë, në të cilën parashikohen kushtet dhe afatet sipas së cilës kredia objekt i kësaj kontrate do të lëvrohet dhe shlyhet nga Kredimarrësi.
- Rast mospërbushje – është mosshlyerja nga ana e Kredimarrësit (njësia e qeverisjes vendore) e kryegjësë dhe/ose interesit ose detyrimeve të tjera të kredisë objekt i kësaj Kontrate në afatet dhe menyrën e caktuar në kontrate.
- Regjistri i Borxhit Vendor – është regjistri i përgatitur nga Ministria e Financave, i cili përmban të dhënat për borxhet e njësisë së qeverisjes vendore.
- Këshilli Bashkiak / Komunal i _____ - është autoriteti vendimmarrës i cili miraton kushtet dhe autorizon lidhjen e kësaj Kontrate midis palëve

[Shënim]

Në këtë seksion përcaktohen termat e përdorur në kontratë. Këto terma janë ato të parashikuar në ligjin numër 9869, datë 4.2.2008 si dhe ato termat bazë që përmbajnë kontratat e kredisë nga bankat.

NENI 2: OBJEKTI

- 2.1** Kredihënësi i jep Kredimarrësit dhe Kredimarrësi merr nga Kredihënësi një Kredi sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë Kredie, këtu më poshtë të quajtur "Kontratë", dhe në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 9869 date 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", si dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 35, datë 5.11.2008.

NENI 3: SHUMA E KREDISË, QËLLIMI I KREDISË

- 3.1** Shuma e kryegjese se kredise, qe Kredihenesi do t' i levroje Kredimarrësit ne zbatim te kësaj kontrate, është përcaktuar në shumën: _____ (_____ milionë) LEK / Euro / Dollarë Amerikanë /
- 3.2** Qëllimi i përdorimit të Kredisë do të jetë për _____.
- 3.3** Kredimarrësi nuk mund në asnjë rast të përdorë Kredinë për një qëllim të ndryshëm nga ai i përcaktuar në pikën 3.2 më sipër. Në rast se Kredihënësi do të kërkojë të ndryshojë këtë

destinacion do të ndiqet procedura e parashikuar në ligjin nr. 9869 datë 04.02.2008 për “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” dhe në aktet nën-ligjore në zbatim të këtij ligji por gjithsesi ndryshimi i qellimit të përdorimit të shumës së kredise do të jete i kushtezuar nga dhënia e miratimit paraprak me shkrim të Kredidhënësit.

[Shënim]

Qëllimi i kredisë për kredinë afatgjate dhe afatshkurtër duhet të jete në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”. Konkretisht, huaja afatshkurtër është për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditeteve, ndërsa huaja afatgjate është: (i) për të financuar shpenzime kapitale, që shërbejnë për një funksion të njësisë së qeverisjes vendore; ose (ii) për të refinancuar hua afatgjate ekzistuese. Sipas nenit 4 pika 2 e Udhëzimit nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore” në rastet kur huaja afatshkurtër është me e madhe se ajo që autorizohet në parim nga këshilli, kjo duhet të miratohet shprehimisht në mënyrë paraprake nga këshilli.

NENI 4: MATURIMI, SHLYERJA

- 4.1** Shlyerja e kryegjese në shumën e përcaktuar në nenin 3 të kësaj Kontrate do të kryhet nëpërmjet _____ (_____) kësteve, 3 (tre) / 6 (gjashtë) / 12 (dymbëdhjetë) mujore secili, duke filluar pagimin e kesitit të pare _____ pas ditës së levrimit të shumës së kredise/kestit të pare të kryegjese.
- 4.1.1.** Shlyerja e interesit do të kryhet nëpërmjet _____ (_____) kësteve mujore/3 (tre) / 6 (gjashtë) / 12 (dymbëdhjetë) mujore secili, duke filluar pagimin e kesitit të pare _____ pas ditës së levrimit të shumës së kredise//kestit të pare të kryegjese.
- 4.2** Maturimi i shlyerjes së kesteve të shumës së kredisë, interesave, plani i pagesës së kesteve dhe shuma e kryegjësë për secilin kështu do të përcaktohen në Planin e Pagesës që bëhet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate menjëherë me nënshkrimin e saj (Planit të Pagesës). Kredimarrësi duhet të nënshkruajë dhe paraqesë Planin e Pagesës në ditën e levrimit të kësaj kredie. Në qoftë se ka më shumë se një levrim, Kredidhënësi do të paraqesë Planin e Pagesës për çdo levrim. Kredimarrësi do të konfirmojë pranimin duke nënshkruar Planin e Pagesës.

[Shënim]

Lidhur me vendimmarrjen për marrjen e kredise, është i nevojshëm që jo vetëm të kërkohej por edhe të reflektohet në kontratë:

(Për rastet e kredive afatgjate) – [referenca ligjore: Neni 7 (pikat 1, 5, 6) i Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, Neni 3 (pika 5, 9) të Udhëzimit nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore”]

- miratimi me vendim nga Këshilli, i kushteve të kredise, garancive të dhëna, si dhe projekt – marreveshjes.
- miratimi i Ministrisë së Financave (qoftë i shprehur me shkrim, qoftë në heshtje me kalimin e afatit 20 ditor)

(Për rastet e kredive afatshkurtra) - [referenca ligjore: Neni 7 (pikat 1, 5, 6) i Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, Neni 4 (pika 2, 3) të Udhëzimit nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore”] Kërkohej miratimi në parim, me vendimin e Këshillit për buxhetin/nese tejkalohej shuma

e autorizuar ne parim me buxhetin, atehere duhet miratim i shprehur per rastin konkret. refuzimi i Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit prane Ministrise se Financave (qofte i shprehur me shkrim, qofte ne heshtje me kalimin e afatit 10 ditor) per ofrimin nga thesari njesise se qeverisjes vendore te huase afatshkurter me ose pa interes.

NENI 5: LËVRIMI

- 5.1 Shuma e kredisë përbëhet nga _____.
- 5.2 Kredidhënisi lëvront shumën e kërkuar, në bazë të njoftimit me shkrim të Kredimarrësit, brenda ____ ditëve pune bankare nga marrja e njoftimit.
- 5.3 Moskërkimi i lëvrimin të plotë të Kredisë objekt i kësaj Kontrate, me skadimin e periudhës 12 mujore nga nënshkrimi i saj, nuk përbën shkak për ndërprerjen e shlyerjes së detyrimeve paraardhëse të Kredimarrësit, dhe/ose pezullimin ose prishjen e kësaj Kontrate. Në këtë rast kjo Kontrate do të konsiderohet e vlefshme dhe e ndryshuar automatikisht vetëm në objektin e saj . Objekti i ri i kontratës do të jetë shuma e kredisë së lëvruar deri në përfundim të periudhës 12 mujore nga nënshkrimi i kontratës plus komisionin e angazhimit për shumën e mbetur të palëvruar sipas përcaktimit të paragrafit 6.7 më poshtë.

[Shënim]Levrimi i kredise duhet te jete i percaktuar ne kontrate dhe nuk eshte vetem ne diskrecionin e njeres pale (kredidhenesit apo kredimarrësit), me perjashtim te overdraft-it ku Kredimarrësit mund te perdore Tepricen Debitore ne llogari vetem me kushtin qe te jete ne perputhje me qellimin e kredise.

NENI 6: INTERESI dhe KOMISIONI

6.1 Varianti A:

Norma e pranuar vjetore e interesit për shlyerjen e kredisë, të përcaktohet si shuma e normës së ndryshueshme me normën e pandryshueshme të interesit, dhe të jetë:

Bono Thesari në Lek të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me afat maturimi _____mujor (norma e ndryshueshme) + _____ (____ pikë _____) pikë %-je në vit (norma e pandryshueshme).

Varianti B:

Norma e pranuar vjetore e interesit për shlyerjen e kredisë është një normë e pandryshueshme prej _____ (_____) pikë %-je në vit.

Interesi qe Kredimarrësi detyrohet t'i paguaje Bankes aplikohet me baza vjetore; numri i diteve/360 (treqind e gjashtedhete) dhe perllogaritet mbi shumen e kredise (Principalin ose Kryegjene) te treguar ne Nenin 1.1. Norma e interesit te kredise do te jete e barabarte me:

- **Norma Baze e Interesit**, qe do te thote indeksi 1 (nje) - vjeçar EURIBOR/LIBOR te publikuar në faqen 'Reuters Screen LIBOR Page'/Indeksin e Bonove te Thesarit, Interesin e Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove te Thesarit me Afat Maturimi 1 (nje) - vjeçar, ne ditën e levrimin te shumes se kredise, (plus) + ____ % (____ perqind), ne vit; megjithate duke parashikuar, qe ne asnje rast, totali i interesit vjetor nuk do te konsiderohet me e vogel se _____ % ne vit.

Interesi vjetor perbehet nga komponentet e meposhtem:

- i) Nje kuote fikse dhe e pandryshueshme (e vendosur nga banka), e barabarte me ____ % (____ perqind);

dhe

- ii) Norma Baze e Interesit e cila eshte nje kuote e ndryshueshme, e barabarte me indeksin 1 (nje) - vjeçar EURIBOR/LIBOR te publikuar në faqen 'Reuters Screen LIBOR Page'/Indeksin e Bonove te Thesarit, Interesin e Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove te Thesarit me Afat Maturimi 1 (nje) - vjeçar. Fillimisht, Norma Baze e Interesit do te jete e barabarte me Indeksin perkates te EURIBOR/LIBOR 1 (nje) - vjeçar te treguar në faqen 'Reuters Screen LIBOR Page'/Indeksin e Bonove te Thesarit, Interesin e Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove te Thesarit me Afat Maturimi 1 (nje) – vjeçar, ne ditën e levrimit te shumes se kredise [*ose nese kredia levrohet me keste, ne ditën e levrimit te kestit te pare*]. Norma Baze e Interesit ndryshon automatikisht çdo vit ne varesi te ndryshimeve ne tregun nderkombetar dhe do te jete e barabarte me indeksin perkates te EURIBOR/LIBOR 1 (nje) - vjeçar te treguar në faqen 'Reuters Screen LIBOR Page'/Indeksin e Bonove te Thesarit, Interesin e Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove te Thesarit me Afat Maturimi 1 (nje) – vjeçar ne datën e pageses se kestit te 12-te (dymbedhete). E njejta menyre perlllogaritje do te perdoret cdo vit deri ne vitin e fundit te kohezgjatjes se kredise. Pervец sa percaktohet me siper, Norma Baze e Interesit do te ndryshoje edhe ne rast se palet vendosin te ndryshojne kuoten fikse dhe te pandryshueshme te interesit dhe do te jete e barabarte me indeksin perkates te EURIBOR/LIBOR 1 (nje) - vjeçar te treguar në faqen 'Reuters Screen LIBOR Page'/Indeksin e Bonove te Thesarit, Interesin e Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove te Thesarit me Afat Maturimi 1 (nje) – vjeçar ne ate date. Per t'u njohur me ndryshimet e interesit kontraktor, qe vjen si pasoje e ndryshimit te Normes Baze te Interesit, Kredimarrësi duhet te paraqitet prane Bankes dhe te marre Skedulën e ri te Ripagimit te Kredise.

Ne asnje rast, pavaresisht zvogelimeve te Normes Baze te Interesit, vlera totale e interesit vjetor nuk do te perlllogaritet, ne raportet ndermjet Bankes dhe Kredimarrësit, me e vogel se _____ % ne vit.

- 6.2** Norma e pandryshueshme, sipas paragrafit 6.1 më sipër, është e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe shlyerjes së Kredisë.
- 6.3** Interesi qe kredimarrësi detyrohet t'i paguaje bankes aplikohet me baza vjetore; numri i diteve/360 (treqind e gjashtedhete) dhe perlllogaritet mbi shumën e kredise (Kryegjese) te treguar ne nenin 3.1 te kësaj kontrate. Kesti perbehet nga pjesa e kryegjese plus interes/pjesa e kryegjese ne kestet e kredise eshte e shperndare njetrajtesisht per te gjithë kohëzgjatjen e kredise, ndersa pjesa e interesit llogaritet mbi shumën e mbetur papaguar te kredise.
- 6.4** Një komision angazhimi prej _____ (_____) % mbi shumën e lëvruar të kredisë do të mbahet nga Kredihënësi menjëherë me lëvrimin e saj.
- 6.5** Paguaje nje komision angazhimi prej _____ (_____)% p.a. (një përqind në vit) per atë pjese te shumës se kredise, e cila është e palevruar. Ky komision aplikohet me baze vjetore. Metoda e llogaritjes eshte aktual/360 (numri i diteve/treqind e gjashtedhete). Komisioni paguhet cdo muaj, duke filluar pagimin e kestit te pare 30 (tridhete) dite pas dites se levrimit te shumes se kredisë, ne perputhje me shumën dhe datat e kesteve, sic percaktohen ne Skedulën e Pagimit te Komisionit te Angazhimit, qe Banka i jep Kredimarrësit ne datat e levrimit te shumave te kredise
- 6.6** Norma Efektive e Interesit (NEI) perben totalin e koston se kredise per Kredimarrësin, e shprehur si perqindje vjetore e vleres se kredise se dhene; dhe llogaritet bazuar ne supozimin

qe kjo kontrate eshte e vlefshme per afatin kontraktor dhe palet permbushin rregullisht detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe menyres se rene dakord ne kete kontrate. Norma Efektive e Interesit (NEI) eshte _____% (_ perqind) ⁵. Ne varesi te ndryshimit te Normes Baze te Interesit (apo edhe te kuotes fikse e te pandryshueshme te interesit vjetor) do te ndryshoje edhe Norma Efektive e Interesit.

[Shënim]

Percaktimi i interesit dhe paraqitja e kalkulimit te tij te jete rast pas rasti, pasi ekziston mundesia qe ne varesi te negociatave qe mund te behen ne njesine e qeversijes vendore te aplikohen edhe elemente te tjere perberes te klauzolave kontraktore qe rregullojne interesin. Konkretisht, ne draftet e Bankes, për te qene ne përputhje me Rregulloren nr. 59, date 29.08.2008 “Mbi transparencen për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”

Shembull i detajuar per mënyrën e llogaritjes se Normes Efektive te Interesit

Shuma e kredisë është 1000 euro, por kredimarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative, kështu që kredia është në fakt 950 euro. Shlyerja e 1200 eurove bëhet 1.5 vjet pas marrjes së kredisë.

Ekuacioni shndërrohet:

$$950 = 1200 / (1+i)^{547.5/365} = 1200 / (1+i)^{547.875/365.25} = 1200 / (1+i)^{18/12} = 1200 / (1+i)^{78/52}$$

Ose:

$$(1+i)^{1.5} = 1200/950 = 1.263157$$

$$1+i = 1.168526$$

$$i = 0.168526$$

Kjo shifër do të rrumbullakoset në 16.9% (ose 16.85 nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).

NENI 7: KUSHTET E SHLYERJES.

- 7.1** Çdo këst përfshin pjesën e kryegjësë (sipas Planit të Pagesës) së bashku me interesat, nderkohe qe Kredimarrësi detyrohet te paguaje edhe kamat - vonesat nëse ka të tilla, te llogaritura sipas kësaj Kontrate.
- 7.2** Në qoftë se ndonjë afat shlyerje përkon me një ditë pushimi për bankën, shlyerja do të kryhet në ditën e parë të punës që vijon.
- 7.3** Të gjitha pagesat e marra nga Kredidhënësi dhe të kryera nga Kredimarrësi, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, do të konsiderohet si vijon:
 - në radhë të parë për shlyerjen e shpenzimeve të kamat vonesave
 - në radhë të dytë për shlyerjen e interesit
 - në radhë të tretë për shlyerjen e kryegjësë (principalit)
- 7.4** Pagesat për shlyerjen e kredisë, do të kryhet nëpërmjet llogarise bankare të Kredimarrësit pranë Kredidhënësit, me transfertë bankare dhe/ose me çdo formë tjetër të ligjshme dhe të

⁵ Neni 7 i Rregullores nr. 59, date 29.08.2008 “ Mbi transparencen pe rproduktet dhe shërbimet bankare e financiare” .

pranueshme nga banka _____. Kredimarrësi ose personat e autorizuar nga Kredimarrësi do të konsiderohen bashkëpërgjegjës për shlyerjen e pagesës/ave.

- 7.5** Kredimarrësi autorizon Kredidhënësin që të debitojë llogaritë e tij pranë Bankës _____ në shumat e nevojshme për shlyerjen e këstit të radhës të kësaj kredie së bashku me interesat dhe kamat vonesat e grumbulluara deri në atë ditë. Nr. i llogarisë i lidhur me urdhrin automatik e periodik për shlyerjen e kredisë është _____
- 7.6** Kredimarrësi mund të shlyejë plotësisht kredinë e lëvruar, në çdo kohë duke njoftuar paraprakisht Kredidhënesin me shkrim _____dite perpara dates se parapagimit dhe duke shlyer plotësisht të gjithë shumën e kredisë përsa i përket kryegjësë (principalit), interesave e kamatëvonesave të grumbulluara në përputhje me këtë Kontratë deri në momentin e shlyerjes.⁶
- 7.7** Kredimarrësi është i detyruar të kryejë pagesat për kryegjënë, interesat dhe kamat vonesat, në të njëjtën monedhë në të cilën Kredia është lëvruar.
- 7.8** Në rast mospërbushje për çfarëdo arsye të Kredimarrësit në pagesën e kësteve sipas kësaj Kontrate, Kredidhënësi do të zbatohet për çdo vonesë, që nga data e përcaktuar në Planin e Pagesës një kamatë vonesë prej% në vit të shumës së pashlyer dhe pa njoftuar Kredimarrësit, mund të debitojë llogaritë e Kredimarrësit me shumat e mësipërme.

Shembull: Në rast se kësti i radhës është në shumën 10'000 lek (dhjetë mijë lek) dhe duhet të paguhet në datë 05 Janar dhe kredimarrësi nuk e kryen këtë pagesë në datën e caktuar atëherë në datë 10 Janar ai është i detyruar të paguajë vlerën prej 10'100Lek (dhjetë mijë e një qind lek) e përbërë nga 10'000 Lek kësti plus 100 lek gjoba për 5 ditë e llogaritur si ne vazhdim 10000Lek/ kësti* 73% ne vit/365dite (gjoba ditore)* 5 ditë në vonesë për pagesën e këstit.

[Shënim]

Duhet mbahet në konsideratë neni 13 i Udhëzimit nr. 35, date 5.11.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, date 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore", sipas të cilit: "Te gjitha veprimet financiare që kanë lidhje me huamarrjen e njesise se qeverisjes vendore, si hyrja e parave, perdorimi i tyre, si dhe shlyerja e kësteve (principalit se bashku me interesin) kryhen nepermjet llogarise se unifikuar te thesarit.". Gjithashtu edhe pikat 3 dhe 4 te udhezimit jane te zbatueshme per rastin konkret.

NENI 8: DETYRIME TË TJERA TË KREDIMARRËSIT

8.1 Kredimarrësi pranon, gjatë gjithë kohës që kjo Kontratë është e vlefshme, të marrë përsipër këto detyrime:

[Opsionale]

- 8.1.1** Të përdor Kredinë vetëm për qëllimin për të cilin është lëvruar;
- 8.1.2** Të vërë në dispozicion të Kredidhënësit sipas afateve të poshtë caktuara dhe çdo herë tjetër që i kërkohet (brenda një afati prej _____ ditë punë nga kërkesa e Kredidhënësit);
- 8.1.2.1** Llogaritjen vjetore të tepicës operative, evidencë në lidhje me stokun e borxhit dhe transfertat e pakushtëzuar të vitit paraardhës brenda datës 1 Mars të vitit në vazhdim.
- 8.1.2.2** Evidencat e të ardhurave nga taksat dhe tarifat lokale dhe të ardhurat e tjera nga aktivitete ekonomike të Bashkisë / Komunës të vitit paraardhës, brenda datës 1 Mars të vitit në vazhdim;
- 8.1.3** Të parashikojë në buxhetin e tij vjetor shumën e shërbimit të borxhit që duhet të paguhet çdo vit sipas kësaj kontrate.

⁶ Pagesa e një komisioni ose jo për parapagimin duhet jete objekt negociatash, përveç kur është vendosur shprehimisht në ligj apo akt nenligjor.

- 8.1.4** Kredimarrësi është i detyruar të lejoje Kredidhënësin (dhe/apo person të caktuar nga Kredidhënësi) dhe Kredidhënësi ka të drejtë që në çdo kohë dhe moment që e shikon të arsyeshme të kontrolloje gjendjen ekonomike, financiare të Kredimarrësve dhe mënyrën e përdorimit të Kredisë prej tij;
- 8.1.5** Kredimarrësi nuk do të krijojë dhe nuk do të lejojë të ekzistojë asnjë garanci ose barrë e çfarëdo lloji qoftë në favor të ndonjë personi tjetër, mbi të ardhurat e vendosura si garanci specifike sipas kësaj Kontrate në favor të Kredidhënësit, pa njoftuar paraprakisht me shkrim Kredidhënësin;
- 8.1.6** Kredimarrësi duhet të njoftojë me shkrim menjëherë Kredidhënësin në rast se do të bëhet subjekt i procedurave të administrimit të paaftësisë paguese sipas nenit 25 të ligjit Nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- 8.1.7** Kredimarrësi është i detyruar të informojë menjëherë Kredidhënësin në rast se ndodhet në vështirësi financiare sipas nenit 23 të ligjit Nr.9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- 8.1.8** Kredimarrësi është i detyruar të paguajë rregullisht secilën nga këstet e kryegjese dhe interesave sipas Planit të Pagesës që Kredidhësi i jep Kredimarrësit sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë.
- 8.1.9** Kredimarrësi duhet të tregojë dëshirën e mirë për bashkëpunim me Kredidhënësin;
- 8.1.10** Në mënyrë të veçantë, Kredimarrësi do të informojë menjëherë me shkrim Kredidhënësin për arsye apo rrethana që mund të shkaktojnë moszbatim apo vonesë të përbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga ana e Kredimarrësve.

NENI 9: ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 9.1** Do të konsiderohen si shkelje të kontratës: (i) nëse Kredimarrësi nuk shlyen dy keste të njëpasnjëshme të kryegjese dhe/ose interesit, (ii) nëse Kredimarrësi është në vonesë për më tepër se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e pagimit të një kesti kredie; (iii) nëse Kredimarrësi nuk përbush detyrimet e përcaktuara në nenin 9 të kësaj kontrate dhe kjo mospërbushje cënon ndjeshëm aftësinë paguese të kredimarrësit, do të konsiderohen si shkelje të kësaj Kontrate
- 9.2** Shkelja e kontratës sipas paragrafit 9.1 më sipër, i jep të drejtën Kredidhënësit të prishë këtë Kontratë dhe të kërkojë shlyerjen e plotë të Kredisë (kryegjësë, së bashku me interesat e penalitetet grumbulluar në bazë të kësaj Kontrate deri në momentin e prishjes).
- 9.3** Prishja e Kontratës hyn në fuqi me njoftimin e saj Kredimarrësit.
- 9.4** Në rast prishjeje të kontratës sipas paragrafit 9.1-9.3 më sipër,⁷ Kredidhënësi ka të drejtë të ekzekutojë menjëherë mjetet e garantimit të kësaj Kredie sipas nenit 10 më poshtë të kësaj Kontrate.

NENI 10: GARANCITË DHE INTERCEPTIMI I FINANCIMIT

- 10.1** Përveç detyrimit të përgjithshëm, për të siguruar ekzekutimin e Kredisë objekt i kësaj Kontrate (kryegjë, interes dhe penalitete të grumbulluara), Kredimarrësi vendos në favor të Kredidhënësit një Garanci Specifike mbi të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i i Shtetit (ndërmjet degës së thesarit).
- 10.2** Të ardhurat e vëna garanci sipas paragrafit 10.1 më sipër, do të identifikohen veçmas në sistemin e thesarit të Republikës së Shqipërisë, të ndara nga fondet e tjera të Kredimarrësit dhe Kredidhënësi gëzon përparësi mbi këto të ardhura kundrejt çdo pale të tretë deri në shumën e detyruar.

⁷ Caktimi i një afati 60 ditor pas dates kur janë vertetuar rastet e shkeljes së kontratës, zgjat në themel afatin e përbushjes së detyrimit dhe sjell si pasoje që Banka nuk mund të fillojë gjatë kësaj periudhe veprimet për ekzekutimin e detyrueshem të detyrimit.

- 10.3** Kredimarrësi vendos, gjithashtu, në favor të Kredidhënësit, për shlyerjen e kësaj kredie, Garancinë shtese të interceptimit të financimit mbi të ardhurat e vena në garanci sipas pikës 10.1 me sipër,
- 10.4** Kredimarrësi bie dakord, që në rastin e prishjes së kontratës sipas nenit 9 me sipër, të autorizojë në mënyrë të përvokueshme sistemin e thesarit të Republikës së Shqipërisë të bëjë lëvizimin automatik të fondeve nga transferuat e pakushtëzuara nga Buxheti i i Shtetit nga llogaria e Kredimarrësit pranë Sistemit të Thesarit në llogarinë bankare të Kredidhënësit me kërkesën e pare me shkrim të bere për këtë qëllim nga ana e Kredidhënësit.
- 10.5** Këto fonde do të kalohen neto nga çdo komision apo tarifë në llogarinë e Kredidhënësit. Si shumë për përmbushjen e detyrimeve të kësaj kredie do të konsiderohet çdo shumë e kredituar në llogarinë e Kredidhënësit. Datë e pagesës së detyrimit do të konsiderohet data në të cilën llogaria e Kredidhënësit është kredituar nga llogaria e Sistemit të Thesarit.
- 10.6** Palet shprehimisht prcaktojnë se pervec kur Ministria e Financave leshon garanci shtetore për kredine, ripagimi i i kredise kryhet nga burimet e parashikuara në kete kontrate dhe nuk perben detyrim të Republikës së Shqipërisë.⁸

NENI 11: DEKLARIMET

- 11.1** Kredimarrësi deklaron se ka të gjitha të drejtat për të kryer këtë veprim dhe për të nënshkruar këtë Kontratë, pa krijuar ndonjë keqkuptim dhe/apo efekte negative për Kredidhënësin. Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate dhe i Dokumenteve të tjera që lidhen me këtë Kontratë nga ana e Kredimarrësit është autorizuar në mënyrë të rregullt prej Këshillit Bashkiak / Komunal..... në përputhje të plotë me Ligjin Nr.9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore", në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.35, datë 05.11.2008, dhe nuk vjen në kundërshtim me ligje, apo akte nënligjore në fuqi, me dispozita të ndonjë marrëveshje borxhi apo marrëveshje tjetër në të cilën Kredimarrësi është palë, dhe nuk shkakton mospërmbushje sipas kuptimit të një marrëveshjeve të tilla. Kjo Kontratë dhe Dokumentet e tjera që lidhen me këtë Kontratë përbëjnë një detyrim të ligjshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj Kredimarrësit në përputhje me kushtet e parashikuara në to.
- 11.2** Kjo Kontratë, dhe as ndonjë Dokument tjetër që lidhet me këtë Kontratë nuk, përmban deklarata të pavërteta, apo fshehin fakte të nevojshme për të bërë deklaratat që përmbajnë këto dokumente, në dritën e rrethanave nën të cilat ato janë bërë, as nuk përmbajnë deklarata ç'orientuese.
- 11.3** Për akordimin e kësaj kredie Kredimarrësi ka marrë vendimin përkatës të parashikuar nga Ligji Nr.9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore" nga Këshilli i Bashkisë / Komunës_____, të miratuar me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtareve të këshillit në një mbledhje të hapur për publikun siç përcaktohet në dispozitat e këtij ligji;
- 11.4** Vendimi i Këshillit përmban miratimin e të gjitha të dhënave të përcaktuara në nenin 7 pika 2 të Ligjit Nr.9869, date 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore", përfshirë miratimin e Garancisë Specifike dhe Garancisë shtese të Interceptimit të financimit;
- 11.5** Njoftimi për mbledhjen e Këshillit është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të ligjit Nr.9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore";

⁸ Neni 9 pika 4 i Ligjit nr. 9869, date 4.2.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore" parashikon që nëse marrëveshja nuk përmban një klauzole të tillë, marrëveshja është e pavlefshme.

- 11.6** Kredimarrësi ka njoftuar rregullisht Ministrinë e Financave brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 7 të ligjit dhe se ky njoftim përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë pikë të ligjit Nr.9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore";
- 11.7** Kredimarrësi deklaron se për akordimin e kësaj kredie ka marrë konfirmimin dhe miratimin përkatës nga Ministria e Financave siç përcaktohet ligjin Nr.9869, date 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore".
- 11.8** Kredimarrësi deklaron se për akordimin e kësaj kredie ka marrë autorizime të tjera të nevojshme dhe ka ndjekur procedurat e përcaktuara në dispozitat e Ligjit Nr.9869, date 04.02.2008 "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore", në Ligjin Nr.8652, date 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.35, date 05.11.2008, apo akte të tjera nënligjore të nxjerra nga Autoritete Publike;
- 11.9** Kredimarrësi deklaron se nuk ka ndonjë procedurë ligjore dhe/apo administrative të hapur apo që pritet të hapet në gjykatë dhe/apo autoritete administrative vendore apo lokale që do të ndikojë në mënyrë negative mundësinë e tij për të shlyer Kredinë dhe të përmbushi detyrimet e kësaj Kontrate.
- 11.10** Kredimarrësi deklaron se ka lexuar, i kupton dhe i pranon të gjitha nenet e kësaj Kontrate si dhe të gjitha rregullat e kredidhënies dhe të shlyerjes që ka Kredidhëni, nuk ka ndonjë vërejtje apo kundërshtim dhe i pranon ato me vullnet të lirë.
- 11.11** Kredimarrësi deklaron që të gjithë informacionet dhe dokumentet e dhëna dhe të paraqitura Kredidhëni, që kanë të bëjnë me këtë Kontratë janë të vlefshëm, të plotë, të vërtetë dhe paraqesin gjendjen financiare aktuale të Kredimarrësit dhe nuk mund të kontestohen nga asnjë njeri përveçse i përket vlefshmërisë së tyre,
- 11.12** Kredimarrësi duke kuptuar se, të dhënat e tyre demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë⁹, si dhe për faktin se Kredidhëni Banka _____ dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme, autorizon Bankën _____ që, për qëllimet që përfshijnë:
- (i) vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
 - (ii) vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time kontraktore të kredisë me bankën _____ dhe/ose
 - (iii) vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit.
- Të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përdorimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jep pëlqimin tim që banka _____ të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.
- 11.13** Kredimarrësi deklaron se ka marrë vendimin për lidhjen e kësaj kontrate, pasi ka shqyrtuar, kuptuar dhe pranuar, kushtet e kësaj kredie, që i janë paraqitur Kredimarrësit nga ana e Kredidhëni në formën e informacionit standard parakontraktor.

⁹ Në rastin e bankave - dege të shoqërive meqë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procesi i vendimarrjes lidhur me miratimin e kredisë mund të kërkojë trajtimin e të dhënave dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Në të gjitha rastet Kredimarrësi është i garantuar për konfidencialitetin e të dhënave sipas nenit 91 dhe 125 të Ligjit nr. 9662, date 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

- 11.14.** Kredimarrësi deklaron se, është vene në dijëni nga ana e Kredithënësit, dhe se kupton dhe merr persiper rrezikun e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e ndryshimeve të kursit të këmbimit të monedhës (në të cilën shprehet kredia) me monedhën vendase.
- 11.15.** Kredimarrësi deklaron se ka dijëni dhe ka kuptuar plotësisht normën e interesit, kamatvonesat për rastet e mosëkzekutimit në afat të detyrimeve kontraktuale, mundësinë e ndryshimit të normës së interesit si rrjedhojë e ndryshimit të Normës Bazë të Interesit.
- 11.16.** Kredimarrësi deklaron se, është vene në dijëni nga ana e Kredithënësit, dhe se kupton dhe merr persiper rrezikun e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e rritjes së normës së interesit vjetor kontraktor, pasojë e rritjes së Normës Bazë të Interesit përgjatë kohezgjatjes së kësaj kontrate.
- 11.17.** Kredimarrësi deklaron se është vene në dijëni të avantazheve dhe disavantazheve, që shoqërojnë marrjen e këtij lloji kredie dhe qëllimin e kredisë.

NENI 12: TË PËRGJITHËSHME.

- 12.1** Të gjitha njoftimet, komunikimet midis palëve të kësaj Kontrate do të bëhen me shkrim, dhe do t'i dërgohet palës tjetër personalisht ose me postë me lajmërim-marrje, në adresën e specifikuar në faqen e parë të kësaj Kontrate ose në adresë të tjera të përcaktuara dhe njoftuar paraprakisht me shkrim palës tjetër .
- 12.2** Kjo Kontratë është hartuar në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Kredimarrësit janë të detyruar ta respektojnë. Për çfarë nuk është parashikuar në këtë Kontratë referimi do të bëhet në Kodin Civil. Kjo kontratë është titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykatë kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit është Gjykata e Rrethit të Tiranës.
- 12.3** Kredithënësi nuk do të konsiderohet në shkelje të kësaj Kontrate në qoftë se legjislacioni Shqiptar apo rregulloret e autoriteteve monetare lokale do të hartojnë rregulla të reja duke e detyruar Kredithënësin të ndryshojë ndonjë nga nenet e kësaj Kontrate.
- 12.4** Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate do të jetë e pavlefshme, jo ligjore apo e pazbatueshme, kjo dispozitë do të anulohet, ndërsa të gjithë dispozitat e tjera do të qëndrojnë në fuqi dhe do të kenë efekt të plotë, përveçse në rastet e parashikuara nga palët apo në këtë Kontratë.
- 12.5** Kjo kontratë përpilohet në 4 kopje, nga një për secilën palë, një për t'u depozituar tek noteri dhe një për t'u depozituar në Degën e Thesarit të Rrethit _____, ku Kredimarrësi si Njësi e Qeverisjes Vendore ushtron aktivitetin e tij

[Unë Noteri ju lexoj palëve me zë të lartë dhe të qartë tekstin e kësaj Kontrate, të cilët pasi deklarojnë se përmbajtja e saj përputhet plotësisht me dëshirat dhe thëniet e tyre, nënshkruajnë me vullnetin e tyre të plotë e të lirë në praninë time dhe unë Noteri vërtetoj këtë akt sipas ligjit në fuqi.]

KREDIDHËNËSI

KREDIMARRËSI

**Përfaqësuar nga Kryetari
i Bashkisë / Komunës
sipas Vendimit të
Këshillit Bashkiak /
Komunal
nr. ____ datë _____**

Emër mbiemër firmë

Emër mbiemër firmë

**vula e Bashkisë /
Komunës**

Emër mbiemër firmë

10.C. MARRËVESHJA E INTERCEPTIMIT TË FINANCIIMIT

Logo e Bashkisë / Komunës

Logo e Bankës / Institucionit Financiar

MARRËVESHJE E INTERCEPTIMIT

Sot më datë _____. _____. 20____ (dymijë e), midis palëve si më poshtë:

- **BANKA**, me seli në adresën: e përfaqësuar nga Z., në cilësinë e huadhënësit.
- **BASHKIA / KOMUNA**....., me adresë _____, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë / Komunës Z. _____, më poshtë e quajtur Huamarrësi.

MEQENËSE:

Palët kanë rënë dakort që të lidhin Kontratën e Kredisë datë20..., bazuar në Nenet 6, 24, 31, 420,585, 1031, 1032 e ne vazhdim të Kodit Civil në Ligjin Nr.9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" (më poshtë referuar si ligji "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore"), në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" (më poshtë referuar si ligji "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore"), si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.35, datë 05.11.2008" (më poshtë referuar si Udhëzimi), si dhe Marrëveshjen e Interceptimit me kushtet e mëposhtme:

[Shënim]

Nga eksperiencia e deritanishme me bankat ato sugjerojnë se është e nevojshme dhënia e pëlqimit dhe marrja përsipër e detyrimeve nga ana e thesarit lidhur me këtë marrëveshje interceptimi, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje si pranues kontrate ose me akt të veçantë në formë shkresore me qëllim që Banka të ketë të drejtë të kërkojë respektimin e kësaj marrëveshje interceptimi e lidhur me Kontratën e Kredisë nga ana e thesarit.

NENI 1: PERKUFIZIME

Në kuptim të zbatimit të kësaj Marrëveshje, termat e treguar kanë kuptimin e mëposhtëm:

- *Banka / Kredihënësi* – do të thotë "Banka" e liçensuar nga Banka e Shqipërisë, fituese e tenderit të organizuar nga Bashkia / Komuna..... e cila do të financojë nëpërmjet kredisë projektin për
- *Njësia vendore / Kredimarrësi* – do të thotë Bashkia/ Komuna....., subjekti i qeverisjes vendore që kërkon financimin e projektit
- *Ministria e Financave* – do të thotë autoriteti shtetëror që miraton dhe mbikqyr zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të kredisë dhe borxhit.
- *Palët* - do të thotë Banka dhe Bashkia / Komuna..... së bashku;
- *"Kredi dhe/ose detyrim"*, dhe/ose *"shuma e kredisë ose kredia"* - do të thotë çdo sasi të hollash që Bashkia / Komuna i detyrohet Bankës, sipas kushteve të kësaj

Marrëveshje dhe që përfshin si kryegjënë dhe interesin, ashtu edhe kamatë vonesat komisionet, taksat, shpenzimet e tjera si dhe çdo shumë tjetër e pagueshme ndaj Bankës në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje.

- *Borxh* – do të thotë shumën e kredisë të marrë në tregun bankar, financiar me kusht kthimi, me ose pa interes, për financimin e projekteve të caktuara.
- *Shërbimi i Borxhit* – do të thotë pagesat që duhet të kryhen në çdo vit fiskal për principalin, interesat, zbritjet dhe pagesat e tjera që rrjedhin nga huatë, përfshirë edhe shpenzimet e lidhura me të.
- *Kontrate Kredie* – do të thotë Kontrata e Kredise datë _____, në të cilën palët kanë rënë dakort për kushtet dhe afatet sipas së cilës Kredimarrësi merr një kredi nga kredidhënësi – Banka _____.
- *Rast mospërbushje* – do të thotë mosshlyerja nga njësia e qeverisjes vendore e kryegjësë apo interesit mbi një kredi në afatet e caktuara.
- *Si dhe çdo koncept i përfshirë në Kontratën e Kredisë Bankare lidhur midis palëve.*

NENI 2: OBJEKTI

- 2.1** Kjo Marrëveshje përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë që të bëhet e mundur kthimi i kredisë bankare në rastin e mospërbushjes së detyrimeve të kredisë nga ana e njësisë së qeverisjes vendore sipas Kontratës së Kredisë Bankare lidhur me Bankën _____, datë _____, që është marrë për financimin e projektit _____ nëpërmjet kredisë nga Banka _____.
- 2.2** Palët bien dakort që të respektojnë dispozitat e Ligjit "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", Ligji "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.35, datë 05.11.2008, si dhe Kontratën e Kredise Bankare datë _____.

Shënim]

Rekomandohet që termat e përdorura në këtë marrëveshje të jenë të njëjta me atë të Kontratës së Kredisë. Në këtë dokument përdorimi i termave i referohet Nenit 510 të Kodit të Proçedurave Civile ku parashikohet se aktet e dhënies së kredive bankare janë tituj ekzekutiv.

NENI 3: KUSHTET E MARRËVESHJES SË INTERCEPTIMIT

- 3.1** Kredimarrësi Bashkia / Komuna _____ në bazë të kësaj marrëveshje jep garanci shtesë për kredinë e marrë me qëllim financimin e projektit _____ me kushte kredie si më poshtë:
- 3.2** Kredimarrësi Bashkia / Komuna _____ në rast mospërbushje, lejon pagesën e kredisë drejtpërdrejt nga transfertat e pakushtëzuara ose taksat e ndara të pagueshme nga Buxheti i Shtetit për llogari të saj.
- 3.3** Këto fonde i paguhen kredidhënësit në përputhje me kushtet dhe rregullat e Kontratës së Kredisë Bankare.
- 3.4** Kredimarrësi Bashkia / Komuna _____ është përgjegjëse për shlyerjen e plotë të kredisë në përputhje me kushtet dhe afatet përcaktuara në Kontratën e Kredisë Bankare.

NENI 4: LLOGARIA E NJËSISË

- 4.1** Kredimarrësi Bashkia / Komuna _____ nëpërmjet kësaj Marrëveshje autorizon Degën e Thesarit _____ dhe vë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në

Ministrinë e Financave që të bëjë lëvrimin automatik të fondeve nga llogaria e Njësise vendore dhe për llogari të kredidhënësit.

- 4.2 Kredia sipas kësaj Marrëveshjeje përbën detyrim të përgjithshëm për Kredimarrësin Bashkia / Komuna, i pagueshëm si shpenzim parësor nga të gjitha fondet, ligjërisht të disponueshme.
- 4.3 Një kopje e kësaj Marrëveshjeje depozitohet në Degën e Thesarit ku Kredimarrësi Bashkia / Komuna ushtron aktivitetin e saj.
- 4.4 Interceptimi i financimit është i mundshëm pasi kjo formë garancie është pjesë e Neneve të Kontratës së Kredisë Bankare lidhur midis dy palëve datë dhe e miratuar me Vendim të Këshillit Vendor me numër protokolli, datë.....dhe miratuar nga Ministria e Financave të kërkesës për marrjen e kredisë me shkresën numër

NENI 5: DEKLARIMET E HUAMARRËSIT

- 5.1 Kredimarrësi deklaron se:

5.1.1 Nënshkrimi dhe zbatimi i Kontratës së Kredisë Bankare dhe Dokumenteve të tjera të Transaksionit nga ana e Kredimarrësi Bashkia / Komuna është autorizuar në mënyrë të rregullt prej saj dhe të gjitha organeve të tjera respektive, dhe nuk vjen në kundërshtim me ligje, apo akte nënligjore të nxjerra nga Autoritete Publike, me Dokumentet Ligjore ose me dispozita të ndonjë marrëveshjeje borxhi apo marrëveshjeje tjetër në të cilën Kredimarrësi Bashkia / Komuna është palë, ose të shkaktojë mospërbushje sipas kuptimit të një marrëveshjeje të tillë. Kjo Marrëveshjeje dhe Dokumentet e tjera të Transaksionit përbëjnë një detyrim të ligjshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj Kredimarrësi Bashkia / Komuna në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshjeje.

5.1.2 Për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Kredimarrësi Bashkia / Komuna ka marrë vendimin përkatës të parashikuar nga ligji "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" nga këshilli për kredinë, të miratuar me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit në një mbledhje të hapur për publikun.

5.1.3 Vendimi i këshillit përmban miratimin e të gjitha të dhënave të përcaktuara në nenin 7 pika 2 të ligjit "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore".

5.1.4 Njoftimi për mbledhjen e këshillit është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të ligjit "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore".

5.1.5 Kredimarrësi Bashkia / Komuna ka njoftuar rregullisht Ministrinë e Financave brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 7 të ligjit dhe se ky njoftim përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë pikë të ligjit "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore".

5.1.6 Kredimarrësi Bashkia / Komuna deklaron se për marrjen e kësaj huaje ka marrë autorizimin përkatës nga Ministria e Financave.

NENI 6: NJOFTIMET

6.1 Të gjitha njoftimet apo komunikimet midis Palëve në këtë Marrëveshje do t'i drejtohen njëra tjetrës në adresat e mëposhtme:

Për: Bankën

Adresa: Bulv. Zhan D'Ark, Tirane

Person Kontakti _____

Tel: _____

Fax: _____

E-mail _____

Për: Bashkinë / Komunën.....

Adresa: _____

Person Kontakti _____

Tel: _____

Fax: _____

E-mail _____

Adresa: Dega _____

Person Kontakti _____

Tel: _____

Fax: _____

E-mail _____

Adresa: _____

Person Kontakti _____

Tel: _____

Fax: _____

E-mail _____

6.2 Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve të kësaj Marrëveshje do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë të rregjistruar (rekomande) në adresat e përcaktuara më sipër në piken 6.1.

6.3 Kredimarrësi Bashkia / Komuna deklaron dhe pranon që të gjitha llojet e njoftimeve të bëra në këtë adresë do të konsiderohen si të marra.

6.4 Kredimarrësi Bashkia / Komuna është e detyruar që të njoftojë menjëherë për çdo ndryshim në adresën e tij. Për sa kohë që Kredimarrësi Bashkia / Komuna nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi Bashkia / Komuna nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.

NENI 7: KOMPENSIMI

7.1 Kredimarrësi Bashkia / Komuna nëpërmjet llogarive të tij, do t'i kompesojë Huadhënësit të gjitha humbjet e pësuar, dëmet, shpenzimet e kostot që do të rezultojnë nga ndonjë rast mospërbushje të detyrimeve nga ana e Kredimarrësit Bashkia / Komuna apo mospërbushje të detyrimeve të tij sipas kontratës së huasë.

7.2 Kredimarrësi Bashkia / Komuna autorizon Bankën në çdo moment të kryejë të gjitha veprimet financiare që kanë lidhje me marrjen e kredise nga ana e Kredimarrësit Bashkia / Komuna si hyrja e parave, përdorimi i tyre si dhe shlyerja e kësteve (kryegjësë me interesin) të gjitha këto do të kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit.

NENI 8: TË NDRYSHME

- 8.1** Palët mund të ndryshojnë, shtojnë përmbajtjen e Marrëveshjes nëpërmjet një akti dy palësh të nënshkruar mes tyre, ndryshime të cilat më parë do të miratohen me vendim të Këshillit të Qeverisje Vendore.
- 8.2** Kjo Marrëveshje Interceptimi e Kredimarrësit Bashkia / Komuna përbën përgjegjësi të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme për këtë njësi, me fuqi detyruese për organet ekzistuese dhe ato të ardhshme të kësaj njësie.
- 8.4** Banka ka të drejtë të kërkojë plotësimin e kësaj Marrëveshje për të çelur Kontratën e Kredisë me Kredimarrësin Bashkia / Komuna për financimin e objektit të Kontratës se Kredisë.

Shënim]

Vendimmarrja dhe miratimet përkatëse lidhur me kredinë rregullohen nga ligji dhe udhëzimi “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” dhe janë kushtet paraprake vlefshmërie te marrëveshjes se financimit.

NENI 9: LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 9.1** Kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje mes palëve të kësaj Marrëveshje, nëse nuk zgjidhet në marrëveshje mes tyre, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor
- 9.2** Kjo Marrëveshje u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila.

PALËT

BASHKIA / KOMUNA.....

KRYETAR

BANKA

Z.....

10.D. LLOGARITJA E KUFIJVE LIGJORË TË HUAMARRJES VENDORE

Kostoja e Shërbimit të borxhit / Kredisë për Bashkinë / Komunën

Ligji për “Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, numër 9869, datë 4.2.2008, krijon një mundësi të re financiare për njësitë e qeverisjes vendore. Bazuar në këtë ligj njësitë e qeverisjes vendore mund të marrin hua afatshkurtër ose afatgjatë për të përmbushur financimin e funksioneve të ekskluzive të tyre ose të deleguara por brenda limiteve të këtij ligji. Ky ligj parashikon tre lloje kriteresh në bazë të të cilave përlogariten kufijtë maksimal të huamarrjes. Këto kriterë janë:

- a. Shërbimi total i borxhit afatgjatë nuk duhet të tejkalojë 20% të totalit të ardhurave të pakushtëzuara (mesatares aritmetike të tre viteve të fundit fiskale. Në totalin e të ardhurave të pakushtëzuara futen të ardhurat e veta të njësisë vendore dhe transfertat e pakushtëzuar e qeverisë)
- b. Shërbimi total i borxhit nuk duhet të jetë më i madh sesa 71% e tepricës operationale të njësisë vendore (teprica operationale llogaritet si diferencë midis të ardhurave të pakushtëzuara me shpenzimet operative nga këto burime)
- c. Stoku i borxhit nuk duhet të jetë më i madh sesa 1.3 herë totali i të ardhurave të pakushtëzuara të bashkisë për vitin e fundit fiskal.

Bazuar në këto kriterë kemi bërë përlogaritjen e sasisë maksimale të borxhit që mund të kontraktojë bashkia / komuna

Bazuar në kriterin e **stokut të borxhit** limiti i një huaje¹⁰ që bashkia mund të marrë në vitin 2010 është:

Viti bazë 2009	Lek Milionë	Euro Milionë	USD Milionë
Kriteri i Stokut	235.8	1.75	2.4
Shuma e huasë që kërkohet të merret	120.0		

Sikurse shihet bashkia nuk po shfrytëzon te gjithë shumën e lejuar sipas ligjit.

Bashkia / komuna ka llogaritur të gjitha kufizimet ligjore për totalin e huasë dhe për shërbimin vjetor të borxhit; për këtë lutem referojuni tabelës me të dhënat financiare të bashkisë / komunës për periudhën 2006-2017.

Bazuar në kriterin e **shërbimit të borxhit** limiti i shërbimeve që mund të bëjë bashkia / komunapër vitin 2010 duke respektuar ligjin e huamarrjes vendore por edhe urdhërin e Ministrisë të Financave numër 857, datë 27.01.2010 kemi bërë përlogaritjet e mëposhtme:

¹⁰ Limiti i stokut nënkupton totalin e shumës së huasë që mund të nënkontraktohet, bazuar mbi të dhënat financiare të bashkisë për vitin 2009, pa futur në të interesat që do të paguheshin për huanë e marrë.

Respektimi i kufizimit të shërbimit të borxhit dhe kështet e bankës

Vite	Periudha	Kufizimi i shërbimit të borxhit	Kështet vjetore sipas Bankes
1	2010	26,251	26,450
2	2011	38,793	25,850
3	2012	42,241	25,850
4	2013	46,587	25,850
5	2014	48,515	25,850
6	2015	52,058	25,850
7	2016	54,737	
8	2017	57,473	
9	2018	60,347	
10	2019	63,364	
	Totali	496,734	155,698

Respektimi i kufizimit të disbursimit të kredisë nga banka

Vite	Periudha	Kufizimi për disbursimin e kredise sipas MF per vitin 2010	Disbursimi rrene dakort me banken per vitin 2010
Total buxheti 2009 i Bashkisë = 328,002,496			
1	2010	16,400,125	15,000,000
2	2011	219,907,048	105,000,000
3	2012		
4	2013		
5	2014		
6	2015		
	Totali	236,307,172	120,000,000

11. KONTRATA E KREDISË DHE MARRËVESHJA E INTERCEPTIMIT TË FINANCIMIT (NËSE PARASHIKOHET) SI NË PARAGRAFIN 10.B DHE 10.C MË SIPËR, DUKE REFLEKTUAR NDRYSHIMET E KËRKUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE)

12. RISHIKIMI I BUXHETIT TË NJËSISË VENDORE DUKE SHTUAR FONDET NGA HUAJA DHE SHPENZIMET KAPITALE QË FINANCOHEN NGA KËTO FONDE

BASHKIA / KOMUNA

Këshilli Vendor

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

VENDIM

Në zbatim të ligjit numër 8652, datë 31.07.2000, neni 32, pika “dh”, ligjit 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, buxheti i vitit, të njësisë vendore Bashkia / Komuna....., shtohet me të ardhura nga huamarrja me shumënlekë, duke e çuar shumën totale të të ardhurave të veta në... lekë dhe njëkohësisht shpenzimet e këtij buxheti shtohen me të njëjtën shumë për shpenzimet kapitale, duke e çuar totalin e shpenzimeve kapitale në... lekë.

Destinacioni i huasë është ai i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak / Komunal, numër....., datë.....

Të njoftohet Prefekti dhe Dega e Thesarit për këto ndryshime.

K R Y E T A R

Këshilli Bashkiak / Komunal

13. SHKRESË PËR DISBURSIMIN E KREDISË

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Për: **Z.**
Drejtor / Drejtoria Operacionale
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit /Ministria e Financave

Z.
Drejtor
Dega e Thesarit

Nga: **Z.**
Kryetar i Bashkisë / Komunës
Bashkia / Komuna

Subjekti: Kërkesë

I nderuar zoti,

Në zbatim të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave numër 35, datë 5.11.2009 “Për zbatimin e ligjit për Huamarrjen e qeverisjes vendore”, lutem bëni të mundur hapjen pranë Bankës Dega, llogarinë tranzitore për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore: Dega e Thesarit- Huamarrje Njësia Vendore në LEKE/ Euro/

Kjo llogari do të funksionojë në përputhje me Akt-Marrëveshjen midis Ministrisë së Financave dhe Bankës

Me respekt,

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

**14. RAPORTIM I SITUATËS NË LIDHJE ME HUAMARRJEN VENDORE TEK
MINISTRIA E FINANCAVE**

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

Për: **Z.**
Ministër
Ministria e Financave

Z.
Drejtor
Dega e Borxhit / Ministria e Financave

Nga: **Z.**
Kryetar i Bashkisë / Komunës
Bashkia / Komuna

Subjekti: Raport mbi situatën aktuale të borxhit / huamarrjes vendore

I nderuar zoti Ministër,

Në zbatim të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, nenet 26 dhe 27 të tij, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave numër 35, datë 5.11.2009 “Për zbatimin e ligjit për Huamarrjen e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 2¹¹ e tij, gjeni si më poshtë situatën në lidhje me huamarrjen vendore të njësisë sonë.

Me respekt,

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

¹¹ *Raportimi gjatë shlyerjes së huasë*

Gjatë kohës që njësia e qeverisjes vendore përdor dhe shlyen financimet nga huatë, ajo duhet t'i raportojë Drejtorisë së Borxhit pranë Ministrisë së Financave çdo muaj, brenda 20 ditëve nga mbarimi i periudhës së raportimit (deri në datën 20 të muajit pasardhës). Raportimi mujor pranë Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave përmban të dhëna mbi shumën e shërbimit të borxhit të paguar në periudhën e raportimit; lëvrimin e fondeve të huasë për llogari të huamarrësit, e të dhëna të tjera të lidhura me huanë sipas formatit A bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Të dhëna mbi nivelet e borxhit publik lokal

		Viti									
		n-3	n-2	n-1	n (aktual)	n+1	n+2	n+3	...	n+...	
A	Shërbimi i borxhit										
	1	Shërbimi ekzistues i borxhit (për hua të kontraktuara)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	a	Principali									
	b	Interesat									
	c	Komisione, etj									
	2	Shërbimi i huasë për huanë që duhet të autorizohet				0	0	0	0	0	0
	a	Principali									
	b	Interesat									
	c	Komisione, etj									
	3	Shërbimi total i borxhit (së bashkua me huanë e re)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
a	Principali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
b	Interesat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
c	Komisione, etj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
B	Stoku i borxhit										
		Stoku ekzistues i borxhit (për hua të kontraktuara)									
		Stoku i ri i borxhit (për huanë që duhet të autorizohet)									
		Stoku total i borxhit									

KRYETARI

Shefi i Financës

Formulari plotësohet për çdo hua të re, apo lëshimin e një garancie të re për të tretët. Tabela paraqet parashikime për kalendarin e pagesave nga viti në vit. Në rastet kur huaja është kontraktuar në monedhë të huaj, konvertimi bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të njoftuar nga Banka e Shqipërisë për kohën e raportimit.

15. KRIJIMI I ANEKSIT TË BORXHIT VENDOR

BASHKIA / KOMUNA

KRYETARI

Nr. Prot.

Datë/...../20.....

VENDIM

Në zbatim të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, neni 27 i tij, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave numër 35, datë 5.11.2009 “Për zbatimin e ligjit për Huamarrjen e qeverisjes vendore”, neni 9 i tij, të krijohet aneksi i borxhit vendor, si pjesë e dokumentacionit financiar dhe buxhetit të konsoliduar të bashkisë / komunës.....

Buxheti i Bashkisë / Komunës përmban aneksin e veçantë mbi borxhin vendor, i cili paraqet gjendjen e gjithë borxheve të pashlyera të njësisë së qeverisjes vendore më datë 1 Janar të vitit buxhetor përkatës. Ky aneks është pjesë organike e buxhetit vendor dhe botohet dhe është i disponueshëm për publikun. Aneksi për borxhin në buxhetin vendor duhet të përmbajë minimalisht të dhënat e mëposhtme, për çdo borxh të pashlyer (marrëveshje financimi apo titull të njësisë së qeverisjes vendore):

- a) Lloji i huasë - marrëveshjes së financimit (p.sh. kredi bankare, etj) apo titulli (p.sh. obligacion)
- b) Viti i emetimit të huasë (miratimi i marrëveshjes së financimit/emetimi i titullit)
- c) Qëllimi i huasë (projekti kapital i cili është financuar nga huaja)
- d) Banka apo institucioni financiar që ka akorduar huanë
- e) Lloji i garancisë për hua, nëse është hua me detyrim të përgjithshëm, apo me garanci specifike, të cilat duhet të identifikohen
- f) Shuma e principalit të marrë hua apo të borxhit të emetuar (në rast titujsh) dhe shuma e interesave të pagueshme gjithsej
- g) Kohëzgjatja (maturimi) i huasë/titullit
- h) Monedha në të cilin është emetuar huaja (marrëveshja e financimit/titulli) dhe kursi i këmbimit në kohën e emetimit të huasë dhe në 1 janar të vitit buxhetor përkatës
- i) Norma e interesit e huasë dhe lloji (interes i ndryshueshëm apo i pandryshueshëm). Në rastin e normës së ndryshueshme të interesit, jepen të dhëna edhe për indeksin e referimit mbi të cilin përcaktohet norma
- j) Mënyra (kalendari) i pagesave – (vjetore; tremujore; mujore apo tjetër; grace period nëse ka)
- k) Shuma e depozituar në fonde rezervë, nëse ka
- l) Principali dhe interesi i pashlyer më 1 janar të vitit buxhetor përkatës
- m) Shërbimi i borxhit për vitin buxhetor përkatës, duke identifikuar veçmas pagesat e principalit dhe pagesat e interesit për vitin fiskal përkatës, përfshirë edhe kosto të tjera të lidhura me shërbimin e borxhit, nëse ka
- n) Tavani i shërbimit të borxhit sipas parashikimeve ligjore

o) Principali dhe interesi i pashlyer më 31 dhjetor të vitit fiskal përkatës

Këto të dhëna raportohen veçmas për çdo hua të pashlyer të njësisë së qeverisjes vendore, përfshirë edhe huat për të cilat kjo njësi ka dhënë garanci, duke evidentuar gjithashtu edhe emrin e personit (palës së tretë) për të cilin është dhënë garancia. Gjithashtu, në aneks raportohet edhe shuma totale e principalit të pashlyer për të gjithë borxhin e njësisë së qeverisjes vendore dhe shuma gjithsej e shërbimit të borxhit të pagueshëm në atë vit.

K R Y E T A R

BASHKIA / KOMUNA.....

3. SITUATA TË TJERA ME TË CILAT MUND TË NDESHEMI GJATË HUAMARRJES VENDORE

Pyejte që me të drejtë janë ngritur nga përfaqësues të bankave por edhe të njësive vendore gjatë procedurave për realizimin e huave vendore janë të shumta por ato më me interes janë:

- Çfarë do të konsiderohet si “moszbatim” i kontratës së huamarrjes?
- Me sa ditë vonesë do të fillojë ekzekutimi i marreveshjes së interceptimit?
- Çfarë ndodh në rast paaftësie paguese?
- A duhet të përrcaktohen procedura të veçanta të ekzekutimit të pasurive të paluajshme të pronave të administruara nga qeverisja vendore?

Në këtë dokument nuk marrim përsipër të japin forma të sakta standart që zgjidhin të gjitha çështjet e mësipërme, por në mënyrë modeste jemi përpjekur të identifikojmë zgjidhje për disa nga ato si më poshtë:

3.1 NË RAST MOSZBATIMI TË KONTRATËS SË HUASË VENDORE NGA ANA E NJËSIVE VENDORE

Nëse identifikohet moszbatimi i kontratës së huasë vendore nga njësitë vendore kundrejt bankave të nivelit të dytë ose institucioneve të tjera financiare rekomandohet që:

Me kërkesë të palës së dëmtuar (Banka e nivelit të dytë / institucioni financiar) Drejtoria e Borxhit / Ministrinë e Financave analizon faktorët që kanë çuar në mospërmbushjen e detyrimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, të cilat mund të jenë:

- Ndodhja e njësisë në vështirësi financiare** – nëse vërtetohen kushtet e përcaktuara në nenin 23, të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008 “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”. Në këtë rast ndiqen përcaktimet e nenit 24 të po këtij ligji “dalja nga vështirësia financiare” dhe respektimi i detyrimeve kundrejt të tretëve (në këtë rast banka/institucioni financiar).
- Paaftësi paguese e njësisë së qeverisjes vendore** – nëse vërtetohen kushtet e përcaktuara në nenin 25 të ligjit numër 9869, datë 4.02.2008. në këtë rast meqënëse ka vakum ligjor pasi paragrafi 2 i këtij neni thotë :”administrimi i paaftësisë paguese dhe

procedurat përkatëse përcaktohen me ligj të veçantë”. Gjithesesi në kushtet kur vërtetohet një situatë e tillë rekomandohet që:

Ministria e Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Borxhit dhe asaj Operacionale të Thesarit, nxjerr situacionin financiar të njësisë vendore menjëherë me marrjen e kërkesës për respektimin e kontratës së huasë vendore nga pala e dëmtuar.

Harton një plan afatshkurtër (i zbatueshëm për vitin korent) buxhetor ku respekton pagesat e pagave dhe kontributeve përkatëse për personelin, dhe për diferencën e të ardhurave bën një skedulim për pagesën e shërbimit të huasë për bankën e nivelit të dytë duke udhëruar degën e thesarit ku kryen aktivitetin njësia vendore përkatëse të bëjë pagesat sipas skedulit të përgatitur nga MF për bankën.

Nëse pagesat sipas skedulit të MF janë më të vogla sesa ato të parashikuara në marrëveshjen e huasë midis njësisë vendore dhe bankës së nivelit të dytë / institucionit financiar, diferencat mbarten për tu shlyer duke u ngarkuar me penalitete sipas parashikimeve të marrëveshjes midis palëve për periudhat e ardhshme.

Afatet kohore për realizimin e këtyre procedurave duhet të jenë të njëjta me ato të parashikuara nga “kodi i procedurave administrative”

3.2 VËNIA NË ZBATIM E MARRËVESHJES SË INTERCEPTIMIT

Marrëveshja e interceptimit nëse është bërë pjesë e kontratës së huasë midis njësisë vendore dhe bankës së nivelit të dytë / institucionit financiar, bëhet objekt i respektimit të shërbimit të borxhit nga ana e njësisë vendore me kërkesë të bankës / institucionit financiar drejtuar degës së thesarit ku ushtron aktivitetin njësia vendore përkatëse.

Afatet se kur konsiderohet vënie në zbatim e kësaj marrëveshje janë të përcaktuara midis palëve brenda marrëveshjes së interceptimit.

Dega e thesarit me të marrë kërkesën nga banka e nivelit të dytë – dërgon informacion pranë Drejtorisë së Borxhit në MF. Kjo e fundit pasi analizon situatën vendos për të vepruar sipas parashikimeve të bëra në pikën 3.1 si më sipër.

3.3 RASTET E PAAFTËSISË PAGUESE

Rastet e paaftësisë paguese janë ato raste të cilat vërtetohen sipas nenit 25 të ligjit numër 9869, datë 4.2.2008 “Për Huamarrjene Qeverisjes Vendore”, administrimi i paaftësisë paguese dhe procedurat përkatëse do të përcaktohen me ligj të veçantë. Deri në miratimin e një ligjit të tillë do të ndiqet procedura e parashikuar në pikën 3.1 si më sipër.

Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri
Rr. Dervish Hima
3 Kullat prapa Stadiumit "Qemal Stafa"
Kulla Nr. 1, Apt. 91, kati 10
Tiranë, Shqipëri
Tel: 355-04-271-355
www.usaid.gov